



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 52 regjistër (JR)
Datë 13.12.2022

Nr. 14 i vendimit
Datë 25.02.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 25.02.2025, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Shefkie Mataj (Demiraj), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 567, datë 28.09.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, dhe Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 567, datë 28.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Shefkije Mataj (Demiraj) [në vijim “subjekti i rivlerësimit”], për shkak të funksionit, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni administroi raportet e kontrollit për subjektin e rivlerësimit, hartuar nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), për kriterin e kontrollit të figurës, sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Gjyqësor (në vijim “KLGj”) për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016.
 - 2.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.
 - 2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar në Komision raportin e kontrollit të figurës² duke konstatuar, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
 - 2.3. KLGj-ja ka përpiluar dhe dërguar në Komisionin një raport të hollësishëm për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit³, bazuar në përshkrimin dhe analizimin: (i) e formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i

¹ Akti i kontrollit të pasurisë me nr. {***} prot., datë 5.10.2018.

² Raporti i DSIK-së me nr. {***} prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së me nr. {***}, datë 20.01.2021.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. {***}, datë 23.11.2021.

rivlerësimi, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të paraqitura prej vetë subjektit të rivlerësimi; (ii) pesë dokumenteve ligjore/dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGj-së.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Shefkie Mataj (Demiraj), bazuar në tri kriteret e rivlerësimit, dhe me vendimin nr. 567, datë 28.09.2022, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vendosi shkarkimin e saj nga detyra. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, përfundimet e Komisionit janë si vijojnë.

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

[...] Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe në provat shkresore të administruara në dosje, trupi gjykues konkludon se:

*(i) Lidhur me pasurinë godinë banimi, 3 kate + papafingo, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimet e kryera në ndërtimin e pjesës së tyre takuese.*

(ii) Lidhur me pasurinë e llojit automjet, të markës “Mercedes Benz”, tip “ML”, vit prodhimi 2008, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen në datën 10.2.2014.

Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. [...]

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

[...] Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. [...]

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

[...] Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe dy çështjeve të tjera gjyqësore të trajtuara, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe dokumentacionit të administruar për këtë kriter, Komisioni çmon se, në vlerësimin e përgjithshëm, nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar nga ligji nr. 84/2016. [...]

III. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), kundër vendimit të sipërpërmbledhur, bashkë me të cilin depozitoi disa akte shkresore në cilësinë e provave të reja. Përmes ankimit, subjekti kërkon që, në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe shkeljeve të parashtruara prej saj në ankim, Kolegji të vendosë:
Ndryshimin e vendimit nr. 567, datë 28.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Shefkie Mataj (Demiraj), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. Gjithashtu, para seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegji “Parashtrime me shkrim, “Shtesë ankimi””, përmes së cilës kërkoj:
 - *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.*
 - *Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese dhe atyre të parashikuara nga KEDNJ-ja, ndaj ankueses Shefkie Mataj (Demiraj), gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*
 - *Administrimin e provave bashkëlidhur ankimit.*
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 567, datë 28.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të ankueses.*
6. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim të konkluzioneve Komisionit, të cilat lidhen me pretendime për shkelje procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe me zbatim të gabuar të ligjit material, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijojnë.

6.1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale: përmes konsideratave të përgjithshme lidhur me parimet e zbatueshme në procesin e rivlerësimit kalimtar, si një proces disiplinor, subjekti i rivlerësimit pretendoi se duhet të ndjekë të njëjtat garanci *mutadis mutandis* si një procedim penal, sa i përket zbatimit të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe parimit të dyshimit në favor të magjistratit *dubio pro reo* si pjesë e tij. Nën këtë interpretim, subjekti i rivlerësimit pretendoi për: (i) interpretim të gabuar të ligjit material e procedural, shkelje të parimit të dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor; (ii) çmuarje të gabuar të provave, në cenim të hapur të parimit të sigurisë juridike dhe interesave të saj të ligjshëm në funksion të këtij procesi; (iii) vendimmarrje të pabazuara në bindjen e brendshme të Komisionit, pa u harmonizuar me vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e provave. Gjithashtu, subjekti pretendoi se, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit dhe vlerësimit tërësor të procedurës së rivlerësimit, pamjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 449.969 lekë, për krijimin e pasurisë automjet, të markës “Mercedes Benz”, tip “ML”, nuk është e mjaftueshme për t’u konsideruar si një deklaram i pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

6.2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë: Subjekti i rivlerësimit ankimon konkluzionet e Komisionit lidhur me pasurinë godinë banimi, 3 kate + papafingo, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, dhe pasurinë e llojit automjet, të markës “Mercedes Benz”, tip “ML”, vit prodhimi 2008, duke pretenduar se ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të tyre, dhe konkretisht:

6.2.1. Lidhur me pasurinë godinë banimi, 3 kate + papafingo, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimet e kryera në ndërtimin e pjesës së tyre takuese, është i njëanshëm, i pambështetur në prova e në ligj, tërësisht i paargumentuar dhe është bazuar në të dhëna ekonomike me natyrë hipotetike. Lidhur me të ardhurat neto nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, të deklaruara prej saj dhe bashkëshortit në mënyrë konsistente, e për të cilat ka paraqitur edhe provë të karakterit shkencor, sikundër është mendimi profesional i ekspertit kontabël, Komisioni nuk ka siguruar asnjë provë të kundërt, dhe nëse niveli neto i këtyre të ardhurave është i dyshimtë për Komisionin, ky fakt nuk mund të jetë në disfavorin e saj në kuptim të parimit të dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor.

6.2.2. Lidhur me pasurinë e llojit automjet, të markës “Mercedes Benz”, tip “ML”, vit prodhimi 2008, konkluzioni i Komisionit për balancë negative prej (-) 449.969 lekësh, sipas bilancit njëmuor, 01.01.2014 - 10.02.2014, është i pambështetur dhe i paargumentuar ligjërisht. Ka rezultuar e provuar se kalimi i pronësisë së këtij mjete bashkëshorti i saj, në vetvete ka qenë marrëdhënie juridike shkëmbimi dhe se nga bashkëshorti i saj, diferenca prej 500.000 lekësh e çmimit të blerjes është paguar pas dy muajsh.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit. Për rrjedhojë, çështja me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankueses

8. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016⁴.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 567, datë 28.09.2022, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Shefkie Mataj (Demiraj) u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në dhomë këshillimi.

⁴ Vendimi nr. 567, datë 28.09.2022, i arsyetuar, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 03.11.2022, dhe sipas lajmërimarrjes postare, konfirmohet dorëzimi më datë 9.11.2022. Subjekti ka depozituar ankimin në Komision me nr. {***} prot., datë 24.11.2022.

Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provës së akteve që kanë shoqëruar ankimin e saj⁵ dhe e vlerësoi atë në raport me parashikimet ligjore të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), i cili parashikon: *Në ankim, nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, si edhe të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit* – dhe konstatoi se provat e paraqitura nuk plotësonin kriteret e parashikuara nga dispozitat e cituara për të gëzuar statusin e provës së re që mund të merret në gjykimin në apel të çështjes.

9.1. Lidhur me aktin “Raport ekspertimi”, të ekspertit J. N., në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti tregtar në periudhën 1994-1997, për të cilin subjekti shprehet se, si rezultat i një analize të thellë profesionale e shteruese, konkluzionet e këtij akti janë *më korrekte dhe më të besueshme në kuptim të ligjit*, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. *Së pari*, në Komision, me prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti tregtar, subjekti ka paraqitur aktekspertimin e ekspertit A. Ç., duke kërkuar që të ardhurat neto të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar të reflektohen sipas konkluzioneve të aktit. Ky akt ekspertimi, i pranuar si provë prej Komisionit, është shqyrtuar dhe analizuar në vendimin objekt gjykimi, duke vlerësuar, ndër të tjera, se: [...] aktekspertimi i z. A. Ç. bazohet tërësisht në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti dhe/apo personi i lidhur. Ai nuk bazohet në legjislacionin e kohës, të dhëna konkrete shkencore, studimore apo dokumentacion mbështetës, si: fatura tatimore blerje/shitje, kontrata të ndryshme, evidenca e të dhëna të tjera mbi qarkullimin. Për më tepër, në këtë akt, nuk janë referuar si shpenzime detyrimet e mundshme tatimore, të cilat, sipas legjislacionit të kohës, do të ishin në përpjesëtim me qarkullimin. Në këtë këndvështrim, Komisioni nuk mund t’i japë fuqi provuese këtij akti, për sa kohë duket se ai mbështetet kryesisht në të dhëna deklarative dhe se nuk i përgjigjet realitetit social-ekonomik të kohës [...]. Subjekti, në ankim, pretendon marrjen si provë të re të një aktekspertimi tjetër lidhur me të ardhurat nga veprimtaria tregtare e bashkëshortit për vitet 1994-1997, sipas saj, me qëllim konstatimin e drejtë të gjendjes faktike, dhe në parashtrimet e paraqitura në Kolegj shprehet: [...] paraqitur ky akt pasi Komisioni është shprehur për aktekspertimin e bërë nga z. A. Ç., depozituar pranë Komisionit, se është i karakterit deklarativ dhe nuk i ka dhënë vlerë provuese kësaj prove shkencore të depozituar nga ana ime [...]. Sa më sipër, subjekti jo vetëm nuk provon se, pa fajin e saj, nuk ka mundur të paraqesë në Komision aktekspertimin e hartuar prej këtij eksperti si provë, por as nuk parashtron argumente që të kundërshtojë vlerësimin e Komisionit për të mos i dhënë vlerë provuese aktekspertimit të paraqitur prej saj, mangësitë e cilit evidentohen qartë në vendimin e Komisionit. Në kontekst të këtyre rrethanave faktike dhe ligjore, paraqitja me ankimin e një aktekspertimi tjetër, në të

⁵ Aktet e bashkëlidhura ankimit janë përkatësisht: (i) raport ekspertimi i ekspertit J. N.; (ii) deklaratë noteriale nr. {***}, datë 22.11.2022, e shtetasit E. K.; (iii) deklaratë noteriale nr. {***}, datë 24.11.2022, e shtetasit H. H.; (iv) deklaratë noteriale nr. {***}, datë 24.11.2022, e shtetasit B. M.

cilin evidentohet korrighimi i njërës prej mangësive të konstatuara në aktekspertimin e administruar dhe vlerësuar prej Komisionit – referimi/përfshirja e detyrimeve tatimore – pasi ndryshimet e tjera kanë të bëjnë me mënyrën e shpërndarjes së disa elementeve të shpenzimeve të paraqitura në vlera të ndryshme nga ato të aktekspertimit të mëparshëm, vlerësohet prej trupit gjykues si përpjekje e subjektit për përmirësimin e situatës së saj financiare. *Së dyti*, duke nënvizuar detyrimin e subjekteve për të paraqitur provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, në zbatim të barrës së provës, e cila, sipas parashikimit të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i takon subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e analizoi dhe vlerësoi aktekspertimin e paraqitur me ankimin në drejtim të vlerës së tij provuese, lidhur me faktet që synonte të provonte. Konkretisht, eksperti shprehet se, për kryerjen e analizës, është bazuar në deklaratimet e bashkëshortit të subjektit dhe, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, nuk identifikohet volumi i të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti privat, por mund vetëm të identifikohet se bashkëshorti i subjektit ka ushtruar aktivitet në tregtimin e artikujve të ndryshëm, kryesisht ushqimorë. Për sa më lart, trupi gjykues konstaton se në aktekspertimin e paraqitur me ankimin, i cili rezulton i pambështetur në dokumentacion mbështetës, si: fatura tatimore blerjeje/shitjeje, kontrata të ndryshme, evidenca e të dhëna të tjera mbi qarkullimin, përlllogariten pothuajse të njëjtat vlera të qarkullimit edhe fitimit neto të realizuar nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, duke sjellë të njëjtën situatë në mbështetje të pretendimeve të subjektit. Pavarësisht se në kuptim të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, ky akt nuk e kalon testin për t’u pranuar si provë prej Kolegjit, trupi gjykues vendosi të marrë në analizë argumentet dhe konkluzionet e tij, të cilat u konsideruan si pjesë integrale e ankimit, i cili është mbështetur thelbësisht mbi to.

9.2. Lidhur me deklaratat noteriale të disa shtetasve të paraqitura me ankimin, trupi gjykues konstaton se me dy prej tyre, njëra e shtetasit B. M., i vetëdeklaruar si ushtrues i aktivitetit tregtar në qytetin e Tropojës, dhe tjetra e shtetasit H. H., shitës në aktivitetin tregtar të bashkëshortit të subjektit, subjekti synon të provojë të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti tregtar. Ndërsa me deklaratën e tretë noteriale, të shtetasit E. K., palë shitëse në kontratën e shitblerjes së automjetit tip “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2008, të datës 10.02.2014, subjekti synon të provojë se bashkëshorti i saj (pala blerëse) ka shlyer diferencën e çmimit të blerjes, në vlerën prej 500.000 lekësh, dy muaj pas lidhjes së kontratës. Përpos se subjekti nuk provon se mosparaqitja e tyre në Komision nuk është për faj të saj e, për pasojë, sjellja e tyre si prova të reja me ankimin nuk përmbush kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit⁶ se, megjithëse e vlefshme në kuptim të ligjit “Për noterinë”, fuqia provuese e deklaratës noteriale në parim dhe veçanërisht e hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, është e dobët, për më tepër që deklaratat noteriale të sipërcituara janë hartuar pasi subjekti është njohur me vendimin e Komisionit për shkarkimin e saj nga detyra. Për pasojë, në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016⁷, trupi gjykues refuzon marrjen e tyre në cilësinë e provës, si të panevojshme për zgjidhjen e çështjes.

⁶ Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 6/2018(JR); nr. 11/2019(JR); nr. 34/2019(JR); nr. 48/2022(JR); nr.37/2023(JR).

⁷ Ndër të tjera, kjo dispozitë përcakton që: “[6.] Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji [...]”.

9.3. Lidhur me aktin e titulluar “Parashtrime me shkrim “Shtesë ankimi””, nga shqyrtimi i përmbajtjes së tij, trupi gjykues e sheh me vend të bëjë një konsideratë të përgjithshme, sipas së cilës rezulton se për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti ka ngritur në të pretendime të reja apo të ndryshme nga ankimi i saj. Koncretisht, *së pari*, për pasurisë *godinë banimi, 3 kate + papafingo, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*, subjekti pretendon se për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare, Komisioni nuk ka vlerësuar mbi bazën e standardit të kostos së ndërtimit të përcaktuar nga EKB-ja, pavarësisht se në vendim shprehet se mbi bazën e tyre duket se vlera e ndërtimit të pasurisë paraqitet më e vogël se vlera e deklaruar prej subjektit. Trupi gjykues konstaton se vlera e ndërtimit, përpos se është deklaruar në deklaratën *vetting*, në deklaratat periodike të pasurisë prej subjektit dhe personit të lidhur, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2015, është deklaruar edhe në Komision, sikundër është deklaruar edhe shpërndarja e saj përgjatë viteve të periudhës kur janë kryer punimet e ndërtimit. Për më tepër, në ankim, subjekti nuk ngre asnjë pretendim për vlerësim të kostos së punimeve të ndërtimit mbi bazën e standardeve të EKB-së, të cilën Komisioni e ka pasqyruar në vendim në kuadër të hetimit administrativ të kryer, në funksion të verifikimit të saktësisë së deklarimeve të subjektit, në kontekst të konkluzioneve të organit ndihmës, ILDKPKI-së. *Së dyti*, lidhur me aktivitetin tregtar të personit të lidhur/bashkëshortit në vitet 1994-1997 në qytetin e Bajram Currit, të ardhurat prej të cilit janë deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë *godinë banimi*, në parashtrime, subjekti pretendon se për shkak të xhiros së madhe, nuk është paguar tatim vjetor minimal prej 50.000 lekësh, por është tatuar në mënyrë proporcionale me të ardhurat e realizuara. Ndërsa në ankim, duke referuar në shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës, drejtuar Komisionit, ku, ndër të tjera, citohet se: [...] *në atë periudhë, nuk ka pasur deklarime të ardhura dhe shpenzime, por janë tatuar me tarifa fikse apo përqindje xhiroje [...]*, subjekti pretendon se provohet fakti që është paguar tarifë fikse, e më tej se: [...] *fakti që legjislacioni i kohës nuk parashikonte deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, por vetëm pagimin e një tarife fikse, që të mundësojë nga organet tatimore përlllogaritjen e fitimit neto, është një fakt juridik që nuk mund të më ngarkojë me përgjegjësi mua si subjekt i rivlerësimit [...]*. Të njëjtin qëndrim, si në ankim, subjekti ka mbajtur edhe në Komision, ku ka pretenduar për pagesën e tatimit sipas një tarife fikse, ndërkohë që, referuar kuadrit ligjor të kohës, Komisioni ka vlerësuar që pagesa e tatimit bazohej në qarkullimin. Sa më sipër, evidentohet në funksion të provueshmërisë së mungesës së konsistencës në qëndrimet e subjektit, pavarësisht se, siç do të analizohet në detaj në lidhje me themelin e pretendimeve, subjekti ka dështuar të provojë të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit në vitet 1994-1997.

9.4. Në këtë situatë faktike dhe ligjore, trupi gjykues sjell në vëmendje se neni 47 i ligjit nr. 49/2012, në bazë të të cilit subjekti paraqet dhe kërkon të shqyrtohet materiali i sipërcituar, parashikon se: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*. Ndërsa neni 49, pika 2 e po këtij ligji, i referuar gjithashtu prej subjektit, parashikon të drejtën e palëve për paraqitjen e parashtrimeve para seancës gjyqësore, mbi të cilën subjektet legjitimohen të sjellin një akt shtesë për t'u pasur në konsideratë prej trupit gjykues: *Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe*

kundërankim. Të dyja këto dispozita përcaktojnë rregullat procedurale se: **(i)** ankuesi, në ankim, si rregull, nuk mund të paraqesë as fakte të reja dhe as prova të reja, që do të thotë se gjykimi në apel do të zhvillohet duke kontrolluar vendimin e dhënë në gjykimin në shkallë të parë, në këtë rast në Komision, mbështetur në të njëjtat fakte dhe prova, përveç kur provohet rregulli përjashtues i mospasjes faj për mosparaqitjen e tyre në shkallë të parë, situatë e cila nuk provohet të ketë ndodhur në rastin objekt shqyrtimi, aq më tepër se konstatimi për shkaqe shtesë bëhet në parashtrime në raport me ankimin dhe jo me faktet e prezantuara në hetim; **(ii)** palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, që nënkupton se në parashtrime nuk mund të paraqiten shkaqe të reja, të cilat as janë ngritur në shkallën e parë dhe as në ankim. Sa më sipër, parashtrimet janë shpjegime shtesë të fokusuara në çështjet më të rëndësishme të ankimit e që i shërbejnë trupit gjykues për të përqendruar diligjencën në ato problematika që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes. Në këtë kontekst, shkaqet e reja të paraqitura në aktin e titulluar “Shtesë ankimi”, vlerësohen prej trupit gjykues se nuk mund t’i nënshtrohen juridiksionit kontrollues dhe rishikues të Kolegjit, për shkak të kufizimeve që parashikojnë dispozitat e mësipërme.

9.5. Subjekti i rivlerësimit pretendoi për vendim të dhënë në kundërshtim me parashikimet kushtetuese, me të drejtat themelore dhe parimet e parashikuara nga KEDNj-ja, për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të cilat në thelb synojnë të kundërshtojnë konkluzionet dhe vendimmarrjen e Komisionit për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, dhe jo aspekte procedurale të procesit. Trupi gjykues nuk identifikoi shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të diktonin formën e gjykimit në seancë gjyqësore publike. Po ashtu, në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjithë pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Për pasojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit dhe në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit në Komision.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

10. Subjekti, pas një parashtrimi në konsiderata të përgjithshme lidhur me parimet e zbatueshme në procesin e rivlerësimit kalimtar, vijon me argumentet lidhur me zbatimin e tyre për kriterin e pasurisë. Pavarësisht se subjekti i parashtron në mënyrë të integruar shkaqet e ankimit me natyrë procedurale me ato të themelit, për lehtësi leximi të këtij vendimi dhe, sipas jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues i analizoi shkaqet e ankimit të veçuara, sipas natyrës së tyre, në funksion të vlerësimit me qartësi më pas të pretendimeve të subjektit lidhur me situatën faktike të pretenduar. Në vijim, analiza e trupit gjykues.
11. Subjekti i rivlerësimit pretendoi për parregullsi të procesit të rivlerësimit, në disa aspekte: (i) çmuarje të gabuar të provave; (ii) lidhur me të ardhurat e aktivitetit tregtar të bashkëshortit, bindja e brendshme e Komisionit, sipas arsytimit në një linjë hipotetike dhe të paargumentuar, e paharmonizuar me vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e provave të administruara, jo vetëm bie

ndesh me to, por ka paragjykuar dhe ka anashkaluar konkluzionet e aktekspertimit të paraqitur prej saj, në shkelje të përcaktimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; (iii) vendimi i Komisionit është rezultat i një hetimi jo të plotë dhe shterues, të cilin ka pasur detyrë ligjore ta kryejë. Trupi gjykues i mori në analizë të gjitha këto pretendime nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore përkatëse, dhe arriti në përfundimin që asnjë prej pretendimeve të subjektit nuk qëndron. Nga analiza e kryer mbi bazën e akteve në dosjen gjyqësore, rezulton se procesi i kryer për subjektin e rivlerësimit ka qenë në përputhje dhe në përmbushje të gjithë garancive kushtetuese, ligjore e konventore për një proces të rregullt ligjor.

11.1. Së pari, trupi gjykues çmon të ndalet në pretendimet e subjektit të rivlerësimit se në procesin e rivlerësimit kalimtar, në zbatim të parimeve të prezumimit të pafajësisë dhe të dyshimit në favor të magjistratit, *in dubio pro reo*, organet e rivlerësimit vendosin në favor të magjistratit sipas rastit, kur faktet e nxjerra nga provat e mbledhura nuk provojnë në mënyrë të qartë dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistencën e shkeljes disiplinore.

11.1.1. Lidhur me këtë pretendim, në referim të opinionit të Komisionit të Venecias⁸, të parashikimeve të nenit 58, “Masat disiplinore”, dhe të nenit 61, “Shkarkimi nga detyra”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të parashikimeve të nenit 100, “Parimet e procedimit disiplinor”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit parashtron se në procesin disiplinor të gjyqtarëve, zbatohen parimet e procesit penal. Për këto pretendime të ngritura edhe nga subjekte të tjera të rivlerësimit, *së pari*, trupi gjykues çmon të theksojë qëndrimin e mbajtur prej Kolegjit se në procesin e rivlerësimit kalimtar, shkarkimi i gjyqtarit apo prokurorit nga detyra është një sanksion kushtetues me natyrë disiplinore dhe jo penale, dhe bazohet në parime, rregulla dhe metodologji të normuar në mënyrë të posaçme nga ligji nr. 84/2016. *Së dyti*, kuadri kushtetues dhe ligjor mbi të cilin mbështet procesi i rivlerësimit, i është nënshtruar ekspertizës së Komisionit të Venecias⁹, vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese¹⁰ dhe zbatimi në praktikë i tij nga organet e rivlerësimit ka kaluar kontrollin e GjEDNj-së përmes disa vendimeve të saj për çështje thelbësore të këtij procesi¹¹. Normat kushtetuese, të materializuara në ligjin nr. 84/2016, lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit, zbatohen në mënyrë autonome e, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për situatë të “ometimit ligjor” apo referim me analogji në kuadrin ligjor penal, vlerësohen prej trupit gjykues, të pabazuara.

11.2. Lidhur me pretendimin për çmuarje të gabuar të provave, nga analiza e akteve të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se vendimi objekt kontrolli i Komisionit përmban analizën dhe vlerësimin e akteve të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, duke çmuar vlerën provuese të tyre në raport me faktet e rezultuara nga provat dhe aktet e tjera të administruara gjatë hetimit. Duke sjellë në vëmendje qëndrimin e GjEDNj-së: “Gjykatat e brendshme kanë një marzh të caktuar vlerësimi, kur zgjedhin argumentet dhe

⁸ Subjekti i referohet opinionit nr. 789, datë 15.12.2014, të Komisionit të Venecias (*Amicus Curia* për Gjykatën Kushtetuese të Moldavisë), duke cituar, ndër të tjera: “Nisur nga ngjashmëria midis procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe procedimit penal, parimi procedural penal i parashikueshmërisë së shkeljeve ligjore dhe interpretimit të ngushtë të tyre (moslejimi i interpretimit me analogji) zbatohet mutadis mutandis edhe në procedimin disiplinor” [...].

⁹ Opinioni CDL - AD (2016).

¹⁰ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017.

¹¹ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafi 306.

vlerësojnë provat, është e detyrueshme për to të justifikojnë këto veprime duke i arsyetuar në vendim¹² – trupi gjykues konstaton se Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimin të tij provat e administruara nga hetimi dhe të sjella prej subjektit të rivlerësimit, duke marrë qëndrim mbi vlerën provuese të tyre. Fakti që disa prej akteve të depozituara prej subjektit, Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej subjektit, nuk do të thotë apriori se çmuarja e tyre ka qenë e gabuar. Në këtë vlerësim, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e GjEDNj-së lidhur me vlerësimin e provave në drejtim të zbatimit në praktikë të garancive të procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit: “Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ”¹³.

11.3. Lidhur me pretendimin se fuqia e provave shkresore përcaktohet drejtpërdrejt nga Kodi i Procedurës Civile dhe nuk është në diskrecionin e organeve të rivlerësimit të përcaktojnë vlerën e tyre, konstatohet se subjekti i rivlerësimit referon shkresa të Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës (në vijim “DRT Kukës”) dhe deklarata noteriale të disa shtetasve, paraqitur prej saj në Komision. Sa u përket shkresave dhe dokumentacionit të përcjellë prej DRT-së Kukës, rezulton se, në bazë të tyre, që me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti është vënë në dijeni prej Komisionit se në vlerësim të këtij dokumentacioni, rezulton e provuar se për periudhën mars 1994 – prill 1997, bashkëshorti i saj ka ushtruar aktivitet tregtar si person fizik, në Bajram Curri, Tropojë. Përderisa, nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga DRT-ja Kukës, nuk kanë rezultuar të dhëna për tatimin e paguar, qarkullimin dhe fitimin e realizuar, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dokumentuar të ardhurat *neto* të përfituara nga realizimi i aktivitetit tregtar të bashkëshortit. Sa më sipër, trupi gjykues nuk gjen asnjë arsye për të cilën mund të pretendohet se në procesin e rivlerësimit në Komision, ky i fundit ka ushtruar pushtet diskrecionar në përcaktimin e provueshmërisë së shkresave të DRT-së Kukës, duke qenë se fakti që ka rezultuar nga këto shkresa, është konsideruar i provuar prej tyre.

11.4. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, deklaratat noteriale të disa shtetasve, të dorëzuara prej saj në Komision, si dhe ato të përcjella me ankimin, përbëjnë provë të plotë të deklaramëve të tyre përpara noterit. Duke sjellë në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të organeve të rivlerësimit për zbehjen e vlerës provuese të deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit edhe në një shkallë më të ulët se ato kanë zakonisht për shkak të natyrës së aktit, pavarësisht vlefshmërisë së tyre në kuptim të ligjit “Për noterinë”, trupi gjykues konstaton se edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Shefkije Mataj (Demiraj), deklaratat noteriale të shtetasve qartazi synojnë të mbështesin pretendimet e subjektit, të pambështetura me të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar. Konkretisht, gjatë hetimit administrativ, lidhur me kërkesën e Komisionit për të depozituar dokumentacion justifikues ligjor/financiar për të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti përpara vitit 2006, subjekti ka shpjeguar se: *për periudhën 1994 deri në vitin 1997, A. M. ka tregtuar artikuj të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë me shumicë dhe pakicë dhe me aktivitetin e tij ka furnizuar edhe Komisariatit e Policisë Tropojë, për vitet 1994, 1995, 1996, si dhe Drejtorinë Spitalore Tropojë, për*

¹² Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja Centro Europa SRL dhe Di Stefano kundër Italisë, 2012; dhe çështja Suominen k. Finlandës, 2003.

¹³ Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja Wierzbicki k. Polonisë, 2002.

periudhën 1995, 1996, 1997. Për këtë periudhë, ka fituar afërsisht 15.400.000 lekë. Për të mbështetur deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të shtetasit H. M., zv.drejtor ekonomik në Drejtorinë e Shëndetit Publik Tropojë në periudhën 1996 -mesi i vitit 1997, si dhe deklaratën noteriale të shtetasit B. H., shef finance në Komisaratin e Policisë Tropojë në periudhën 01.03.1993 - 01.05.1998. Deklaruesit deklarojnë furnizime prej subjektit tregtar market “{***}”, sipas kontratave të lidhura me administratorin/bashkëshortin e subjektit, të institucioneve respektive ku ata kanë ushtruar detyrat dhe institucioneve të varësisë, dhe se likuidimet janë bërë në rrugë bankare. Deklaruesit deklarojnë artikujt ushqimorë dhe industrialë objekt i kontratave me subjektin tregtar market “{***}”, ndër to edhe mobilie, dyshekë, çarçafë, batanije etj., pa deklaruar qoftë edhe vlera të përafërta të kontratave në kontekst të buxhetit përkatës institucional, në dijeni të deklaruesve për shkak të funksioneve të ushtruara. Për rrjedhojë, deklaratimet duket të vijnë në favor të interesave të subjektit lidhur me pretendimet për zhvillimin e aktivitetit tregtar me shumicë, pa u mbështetur në ndonjë dokumentacion që do të forconte vlerën provuese të tyre, ndërkohë që, siç analizohet gjerësisht në vijim, referuar akteve të administruara prej DRT-së Kukës, subjekti fizik “{***}” nuk rezulton i regjistruar për zhvillimin e aktivitetit tregtar me shumicë dhe ka zhvilluar aktivitetin tregtar në një ambient me sipërfaqe 32,3 m². Në këndvështrim të sa më sipër, deklaratat noteriale të sipërcituara nuk kanë fuqi provuese në procesin e rivlerësimit të subjektit.

11.5. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë nenin 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka provuar faktin se ndodhet në kushtet e pamundësisë për të gjetur dokumentacion për fitimin *neto* të realizuar nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, se organet tatimore nuk e disponojnë e, për rrjedhojë, ndodhet *përpara prezumimit ligjor dhe nuk ka barrë prove për të provuar të pamundurën*. Sipas subjektit, në këto kushte, me paraqitjen e provës me karakter shkencor, sikundër është mendimi profesional i ekspertit kontabël, si dhe për faktin se Komisioni nuk ka siguruar asnjë provë të kundërt lidhur me nivelin e të ardhurave *neto* nga aktiviteti tregtar, i deklaruar prej saj dhe personit të lidhur/bashkëshortit, organet e rivlerësimit duhet të zbatojnë parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekti i procedimit disiplinor.

11.5.1. Trupi gjykues vlerëson se barra e provës e kaluar prej Komisionit, lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar, vjen në përputhje të plotë me kuadrin kushtetues dhe ligjor të procesit të rivlerësimit, i cili përcakton detyrimin e organeve të rivlerësimit, në këtë rast Komisionit, t’i kalojnë barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për situata që ngarkojnë subjektin me përgjegjësi. Duke sjellë në vëmendje parashikimin kushtetues: *Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*, i materializuar në dispozitat përkatëse të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se fakti që, për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk detyron Komisionin të pranojë apriori faktet e deklaruar prej subjektit, në këtë rast vlerën e të ardhurave të aktivitetit të bashkëshortit, pa ia nënshtruar këtë vlerë të deklaruar një analize mbi bazën dokumentare, rrethanash faktike e legjislacionit të zbatueshëm. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se, me parashtrimet në Komision, subjekti nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur

me barrën e provës për të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit dhe, në përmbushje të saj dhe të misionit të organeve të rivlerësimit, ka paraqitur aktekspertimin e përpiluar nga eksperti A. Ç., për të cilin në ankim ngre pretendime se, në mënyrë të pabazuar, është anashkaluar nga Komisioni. Po kështu, me ankimin, subjekti paraqet një akt ekspertimi tjetër, si përmbushje e detyrimit kushtetues dhe ligjor për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë godinë banimi 3 kate + papafingo, dhe të ardhurave të bashkëshortit, pavarësisht pretendimeve që ngre për barrën e provës lidhur me to.

11.5.2. Aktekspertimi i depozituar prej subjektit në Komision, për të provuar të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti tregtar, duke kërkuar që të ardhurat të reflektohen sipas konkluzioneve të tij, i administruar në cilësinë e provës prej Komisionit, është vlerësuar në harmoni me provat e tjera të administruara dhe shpjegimet e dhëna prej subjektit. Komisioni ka vlerësuar se nuk mund t'i jepet fuqi provuese këtij akti për sa mbështetet kryesisht në të dhëna deklarative dhe nuk i përgjigjet realitetit social-ekonomik të kohës: bazohet tërësisht në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti dhe/apo personi i lidhur, nuk bazohet në legjislacionin e kohës, të dhëna konkrete shkencore, studimore, dokumentacion mbështetës, si: fatura tatimore blerjeje/shitjeje, kontrata të ndryshme, evidenca e të dhëna të tjera mbi qarkullimin, nuk janë referuar si shpenzime detyrimet e mundshme tatimore, të cilat, sipas legjislacionit të kohës, do të ishin në përpjesëtim me qarkullimin. Në ankim, subjekti citon përfundimet e këtij akti ekspertimi, shprehet që *ka kërkuar vlerësimin e tij si akt ekspertimi privat*, pa parashtruar asnjë argument për të kundërshtuar shkaqet për të cilat Komisioni ka vlerësuar të mos i japë vlerë provuese këtij akti. Mungesa e argumenteve për të kundërshtuar vlerësimin e Komisionit, dedukton synimin e subjektit për të mbështetur deklarimet e saj e, në funksion të përmirësimit të situatës financiare, përmes paraqitjes së një dokumenti të pabazuar as në dokumentacion dhe as në legjislacionin e kohës. Subjekti shprehet se në aktekspertimin e paraqitur bashkëlidhur ankimit: *[...] çdo veprim teknik i kryer nga ana e ekspertit deri në konkluzionet e arritura prej tij, është harmonizuar me kuadrin ligjor, i cili ka qenë në fuqi në atë kohë dhe ka rregulluar sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë [...]*, me të cilin duket të pranojë ekzistencën e të metave të aktekspertimit të paraqitur në Komision. Në këtë situatë ligjore dhe faktike, pretendimet e subjektit që, sipas pikës 3 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016¹⁴, të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, të deklaruara prej saj, si pohim edhe i ekspertit, duhet të pranoheshin si të mirëqena, edhe për sa Komisioni nuk ka caktuar ekspert apo nuk ka siguruar asnjë provë të kundërt lidhur me nivelin e tyre, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara dhe veprimtaria procedurale e Komisionit si e ushtruar brenda tagrave të tij të dhënë nga ligji.

11.6. Lidhur me pretendimin se *fakti që legjislacioni i kohës nuk parashikonte deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, por vetëm pagimin e një tarife fikse, që të mundësojë nga organet tatimore përlllogaritjen e fitimit neto, është një fakt juridik që nuk mund të më ngarkojë me përgjegjësi mua si subjekt i rivlerësimit*, pa kaluar në përsëritje të sa më lart, trupi gjykues vëren se, në të kundërt të këtij pretendimi, Komisioni, edhe pse në referim të ligjit të kohës nr. 7679, datë 03.03.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël” (në vijim “ligji nr. 7679/1993”), ka evidentuar se parashikohej pagesa e tatimit bazuar mbi qarkullimin dhe jo një tarifë fikse, siç subjekti ka pretenduar, ka vlerësuar se, pavarësisht të gjithë përpjekjeve për të siguruar

¹⁴ Neni 49 i ligjit nr. 84/2016, i titulluar “Mjetet për kërkimin e provës”, në pikën 3 parashikon: “3. Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”.

informacion mbi të ardhurat e realizuara nga zhvillimi i aktivitetit tregtar të bashkëshortit për vitet 1994-1997, subjekti nuk ka mundur të disponojë të dhëna konkrete për shkak të informacionit të cunguar të dërguar nga DRT-ja Kukës. Komisioni ka vlerësuar të bazuar pretendimin e subjektit se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar informacion për këto të ardhura, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pamundësia e organeve tatimore për të përlllogaritur fitimin *neto* të aktivitetit tregtar të bashkëshortit nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi, vlerësohet nga trupi gjykues krejtësisht i pabazuar përderisa Komisioni, në mungesë të këtyre të dhënave dhe pa ngarkuar apriori subjektin me përgjegjësi, ka përlllogaritur në mënyrë hipotetike dhe garantiste, në konsideratë të të gjitha rrethanave të rezultuara lidhur me rastin, një vlerë të të ardhurave të mundshme, të cilat janë konsideruar si të krijuara, edhe pse në mungesë të dokumentacionit që i provon ato.

11.7. I pabazuar u vlerësua edhe pretendimi i subjektit se konkluzioni i Komisionit lidhur me pasurinë godinë banimi, 3 kate + papafingo, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, është tërësisht i paargumentuar në kuptim të ligjit, është bazuar më tepër në të dhëna ekonomike me natyrë hipotetike e të paargumentuara, duke cenuar hapur parimin e sigurisë juridike dhe interesat e saj të ligjshëm në funksion të këtij procesi. *Së pari*, në përputhje me nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konstatohet se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri, është bazuar në parashikimet ligjore të kohës, në dokumente nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, duke çmuar, sipas bindjes së brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. *Së dyti*, mbi bazën e një analize të plotë të shtjelluar në vendim, Komisioni ka çmuar se pretendimet mbi qarkullimin dhe fitimin e realizuar, të deklaruara prej subjektit dhe të mbështetura prej saj me provën e paraqitur – aktekspertimin e përpiluar nga eksperti A. Ç. – nuk i përgjigjen realitetit social- ekonomik të kohës. Çmuarja prej Komisionit: *rezulton i vështirë realizimi i një qarkullimi prej rreth 104.000.000 lekësh, për një periudhë 4-vjeçare nga zhvillimi i këtij aktiviteti tregtar në qytetin e Bajram Currit, në njësinë e shërbimit me sipërfaqe prej vetëm 32,3 m², shifër e konkluduar prej ekspertit, nuk mund të pretendohet as si joobjektive dhe as si paragjykim i konkluzionit të aktekspertimit, për sa kohë mbështetet në një analizë të arsyeshme të të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi dhe të fakteve të gjithëpranuara historiko-sociale të zonës. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon të rritheksojë se paraqitja me ankimin e një aktekspertimi tjetër, evidenton edhe vetë ndërgjegjësimin e subjektit lidhur me mangësitë e aktekspertimit të administruar si provë prej Komisionit. Së treti*, në kushtet kur subjekti ka dështuar të provojë me provën e paraqitur pretendimet mbi qarkullimin dhe fitimin e realizuar, për të verifikuar qarkullimin e mundshëm/të pranueshëm të realizuar nga subjekti tregtar “{***}”, Komisioni ka kryer një vlerësim alternativ dhe tejet objektiv të të gjitha rrethanave të tjera të përfituara gjatë hetimit administrativ, duke u bazuar kryesisht në përcaktimet e ligjit të kohës nr. 7679/1993, ku në shkronjën “gj” të nenit 3, parashikohej se masa e tatimit për tregtarët që bëjnë tregti me shumicë, të çdo lloji, është 6% e të ardhurave, por jo më pak se 50.000 lekë/vit. Mbi këtë bazë, Komisioni, në një qasje garantiste, për periudhën 4-vjeçare, ka kryer analizimin dhe përlllogaritje të qarkullimit dhe fitimit për subjektin tregtar “{***}”, sipas një rasti të mundshëm hipotetik të realizimit të 10-fishit të qarkullimit vjetor për të cilin kishte detyrimin për të paguar tatimin minimal të parashikuar, prej 50.000 lekësh. Sa më sipër, analiza dhe përlllogaritjet e kryera, në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016,

pasqyruar në mënyrë të qartë e të plotë në vendim, bëjnë që vendimi i Komisionit të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016¹⁵, qoftë në këndvështrim të përmbajtjes, ashtu edhe strukturës.

11.7.1. Përveç sa më sipër, 10-fishi i vlerës së qarkullimit që do të rezultonte sikur subjekti tregtar të kishte paguar tatimin minimal të përcaktuar në ligj, për një aktivitet tregtar të zhvilluar në një njësi me sipërfaqe prej 32,3 m², ndonëse në mënyrë hipotetike, ka ofruar garanci tejet të arsyeshme dhe logjike maksimale për subjektin e rivlerësimit. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, i kryer prej Komisionit, nuk përbën në asnjë këndvështrim cenim të sigurisë juridike, dhe argumentet e subjektit për të kontestuar legjitimitetin e vlerësimit pasuror të kryer prej Komisionit, janë të pabazuara. Trupi gjykues, duke sjellë në vëmendje që procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016¹⁶, duhet të identifikojë subjektet që kanë në pronësi ose përdorim *pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht*, dhe se kompetencat e organeve të rivlerësimit për të vlerësuar çdo indicie sipas bindjes së tyre të brendshme, janë të njohura nga kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, përjashtojnë ekzistencën e ndonjë shkakut ligjor që cenon parimin e sigurisë juridike.

11.8. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit dhe, në vlerësim tërësor të procedurës, ku nuk janë konstatuar probleme në kontrollin e kriterit të figurës dhe të aftësive profesionale, pamjaftueshmëria financiare për blerjen e automjetit “Mercedes Benz”, e konstatuar në vlerën (-) 449.969 lekë, nuk është e mjaftueshme për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

11.8.1. Trupi gjykues e vlerëson edhe këtë pretendim të pabazuar, në konsideratë të rrethanave konkrete. Parimi i proporcionalitetit, parashikuar në pikën 1 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ka për qëllim që masa disiplinore të jetë në proporcion me shkeljen e konstatuar. Sikurse ka arsyetuar Kolegji në vendime të mëparshme¹⁷, proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i rivlerësimit. Në vendimin objekt ankimi, përpos pamjaftueshmërisë për krijimin me burime financiare të ligjshme të pasurisë automjet, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në po të njëjtat kushte edhe për krijimin e pasurisë godinë banimi 3 kate + papafingo. Këto konkluzione, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, duke vendosur shkarkimin e saj nga detyra sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e bëjnë të pabazuar kërkesën e subjektit për çmuarjen e pamjaftueshmërisë financiare të konstatuar për

¹⁵ Neni 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “[...] 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi [...]”.

¹⁶ “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarami dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.”

¹⁷ Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 20/2020 (JR), datë 08.09.2020; nr. 36/2020 (JR), datë 16.12.2020.

krijimin e pasurisë automjet, si një çështje më vete, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit.

11.9. Në përmbledhje, në kushtet kur asnjë e dhënë në aktet e administruara dhe as në parashtrimet e subjektit, nuk tregojnë qoftë edhe indicie për një vendim të dhënë në kundërshtim me parashikimet kushtetuese dhe ato ligjore të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, apo me të drejtat themelore dhe parimet e parashikuara nga KEDNJ-ja, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, ndër to edhe se: *qëndrimi i Komisionit ka shtuar fiktivisht pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare*, vlerësohen nga trupi gjykues të pambështetura në fakte dhe si një përpjekje që synon delegitimimin e procesit të kryer në kontekstin e themelit, duke ngritur shkaqe ankimi mbi rrethana që konstatohen se nuk ekzistojnë.

C. *Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

C.1. *Pasuria “shtëpi banimi”, tri kate + papafingo, e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

12. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratat periodike të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si subjekt deklarues për disa vite pranë ILDKPKI-së. Lidhur me konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri – *mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimin në pjesën takuese* – subjekti i rivlerësimit ngre shkaqe ankimi dhe pretendime lidhur me vlerësimin e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, deklaruar si njëri prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie. Për rrjedhojë, referuar akteve në dosjen gjyqësore, në vijim, lidhur me këtë pasuri, pasqyrohen deklarime/shpjegime/të dhëna lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit të subjektit, kryesisht të periudhës 1994-1997 si personi fizik “{***}”, në Bajram Curri, e po ashtu edhe për aktivitetin tregtar të ushtruar prej tij si individ, në periudhën 1997-2000.
13. Në deklaratën *vetting*, pasuria “shtëpi banimi”, tri kate + papafingo, e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, deklarohet prej subjektit si e ndërtuar vetë në vitet 1998-2012, legalizuar në datën 6.8.2012, regjistruar në ZVRPP Tiranë në datën 20.11.2012, rivlerësuar në datën 23.5.2013, me vlerë 20.000.000 lekë. Subjekti ka deklaruar se kati i parë është në pronësi të familjes së vëllait të bashkëshortit, të ndjerit S. H., ku jetojnë familjarët e tij, me kontribut të tyre prej 5.000.000 lekësh, si dhe burimet e krijimit të kësaj shume. Ndër burimet e krijimit të pjesës takuese të saj dhe personit të lidhur/bashkëshortit në ndërtesë, subjekti deklaron: *Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortit A. H. (M.) për periudhën 1994-2000 në Tropojë: (i) 1994-1997 tregtim i artikujve ushqimorë dhe industrialë, me pakicë e shumicë [kod fiskal nr. {***}, nr. serial {***}]; (ii) 1997-2001 grumbullim dhe shitje bimë medicinale. Vlera 15.000.000 lekë.*

13.1. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka depozituar:

(i) Kthim përgjigjeje prej DRT-së Kukës nr. {***} prot., datë 11.11.2006, përmes së cilës njoftohet kërkuesi/bashkëshorti i subjektit, se nga verifikimi i bërë në zyrat e Agjencisë Tatimore Tropojë, rezulton se personi fizik “{***}” ka qenë i regjistruar në Degën e Tatimeve Tropojë për periudhën 9.03.1994 - 3.12.1997, me kod fiskal nr. {***}, nr. serial {***}, me aktivitet tregtim i artikujve të ndryshëm industrialë e ushqimorë, me adresë: lagjja “{***}”,

Bajram Curri, Tropojë. Dosja e personit fizik ndodhet në Agjencinë Tatimore Tropojë me nr. {***}, të vitit 1994.

(ii) Vërtetim nga ISSH-ja për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto të shtetasit A. M., për periudhën 1.01.1994 - 1.02.1997, ku konstatohet se për vitin 1994, nuk ka derdhur kontribute. Gjithashtu, në deklaratën *vetting*, në formularin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, për personin e lidhur/bashkëshortin, deklarohet punësimi dhe të ardhurat përkatëse prej datës 04.09.1984 e vijim, përjashtuar periudhën 1994 - 2000, ku sipas deklarimit për burimet e krijimit të pasurisë së sipërcituar, deklarohet kryerja e aktivitetit tregtar dhe vlera e të ardhurave.

14. Referuar deklaratave të pasurisë (në vijim “DIPP”), rezulton se në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shtëpi banimi me sip. 180 m² dhe truall me sip. 400 m²; vlera 30 milionë lekë¹⁸; pjesë takuese: 50%; burim krijimi: të ardhura nga aktiviteti privat i b/shortit A. M., periudha prill 1994 - korrik 1997 në Tropojë (artikuj ushqimorë dhe industrialë); të ardhura vjetore në milionë/lekë: 7. Në deklaratat e pasurisë në vitet vijuese, subjekti nuk ka deklaruar lidhur me vlerat e investuara në ndërtimin e kësaj pasurie. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: *shtëpi banimi 3 kate + papafingo, ndërtuar në vitet 1998-2012, e legalizuar me nr. {***}, datë 6.8.2012, e regjistruar në ZVRPP në pronësinë e bashkëshortit, një kat banimi është i nënës dhe familjes së kumatit, vlera 15.000.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: godinë banimi 4 kate dhe truall me sip. 461,5 m², ndërtuar në vitet 1998-2012, legalizuar me nr. {***}, datë 6.8.2012, regjistruar në ZVRPP me nr. {***}, datë 20.11.2012, një kat banimi është i nënës dhe familjes së kumatit. Rivlerësuar më datë 23.05.2013. Vlera e rivlerësimit: 67.766.719 lekë.**
15. Gjithashtu, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në deklaratën e interesave privatë përpara fillimit të detyrës në vitin 2012, deklaroi: *shtëpi 3 kate plus papafingo*, ndërtuar në vitet 1998-2012, e legalizuar me nr. {***}, datë 6.8.2012. Është në proces regjistrimi në ZVRPP. Një kat banimi është i nënës dhe familjes së vëllait (konkretisht kati i dytë); sipërfaqe ndërtimi 673 m²; vlera: 15.000.000 lekë; burimi i krijimit kontributi financiar i bashkëshortëve nga punë të ndryshme, si dhe puna e tij në sektorin privat në vitet 1994-2006, e dokumentuar dhe deklaruar nga Shefkie Mataj (Demiraj). Në DIPP-2012, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit deklaroi pasurinë *shtëpi banimi 3 kate + papafingo*, me vlerë 15.000.000 lekë, vendosur sipas shpenzimeve të kryera prej tyre. Në DIPP-2013 deklaroi pasurinë *godinë banimi 3 kate + papafingo*, vlerën e rivlerësuar në datën 23.05.2013, prej 67.766.719 lekësh.
16. Të pyetur nga ILDKPKI-ja¹⁹ më datë 20.02.2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, ndër të tjera, kanë deklaruar se shtëpia private 3 kate + papafingo, e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, përbëhet nga kati përdhe, sallë fitnesi familjare, kati i parë i banimit është i familjes së vëllait të bashkëshortit të subjektit (të ndjerit S. H.), kati i dytë ku banon familja e tyre dhe

¹⁸ Referuar deklarimeve në deklaratë, prej Komisionit është konstatuar se subjekti ka kryer deklarimin në lekë të vjetra.

¹⁹ Në përgjigje të kërkesave për informacion dhe dokumentacion, lidhur me kontrollat e kryera ndaj subjektit Shefkie Demiraj (Mataj) dhe ndaj bashkëshortit të saj A. M., adresuar në ILDKPKI me shkresat nr. {***} prot., datë 1.02.2022, dhe nr. {***} prot., datë 1.02.2022, Komisioni ka administruar përgjigjen dhe dokumentacionin përkatës të dërguar prej ILDKPKI-së me shkresën nr. {***} prot., datë 11.02.2022, “Sqarime në lidhje me deklarimin e pasurisë ndër vite sipas kërkesës së inspektorës”, nënshkruar nga Shefkie Mataj (Demiraj) dhe A. M., datë 20.02.2015.

papafingoja e pabanuar. Ndërtimi i shtëpisë ka zgjatur nga viti 1998 deri në vitin 2006, kur ka mbaruar karabinaja (soleta, trarë, kolona, mure), dhe deri në vitin 2011 si rifiniturë (punimet brenda – elektrike, hidraulike, pllaka, suvatime), disa punë janë kryer edhe në vitin 2014 dhe do të vazhdojnë në vijim. Vlera totale e katit përdhe, katit të dytë dhe papafingos deklarohet 15.000.000 lekë, me burim krijimi kontribute të bashkëshortëve në vite, ndër to fitimet nga biznesi në qytetin e Bajram Currit, minimarket “{***}” në vitet 1994-1997, puna e bashkëshortit me bimë mjekësore 1997-2000, menaxhim punimesh në sektorin e ndërtimit 2000-2006, e më pas në sektorin shtetëror siç është deklaruar në vite.

17. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit gjatë hetimit administrativ²⁰, për të deklaruar, ndër të tjera, mbi periudhën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të godinës, investimet e kryera/shpenzimet e realizuara në mënyrë kronologjike në funksion të ndërtimit dhe kompletimit të godinës së banimit 3 kate + papafingo dhe burimin konkret të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për çdo shpenzim të kryer, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) vlera në total e investuar nga familja e saj ndër vite, është 15.000.000 lekë, ndërsa nga familja e kunatit është 5.000.000 lekë, kontributi i është dhënë bashkëshortit të saj dhe prej tij janë shpenzuar sapo i ka marrë; (ii) deri në fund të vitit 2003, vlera e shpenzuar ishte 9.000.000 lekë (6.000.000 lekë vlera e banesës së ndërtuar + 3.000.000 lekë vlera e materialeve të blera dhe magazinuara, të cilat do të përdoreshin për ndërtim, si dhe vlerat e investuara në periudhën 2004-2012²¹.
18. Në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, nga analiza paraprake e treguesve financiarë, Komisionit i ka rezultuar pamundësi financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 2.483.250 lekë për blerjen në datën 31.7.1998, të pasurisë së llojit “truall”, në Tiranë, mbi të cilin është ngritur godina, për kryerjen e investimeve në objektin 3 kate + papafingo për periudhën deri më 31.12.2003, e po ashtu dhe për vitet 2004 – 2012. Për pasojë, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës mbi konstatimet e mësipërme që lidhen me pamundësinë financiare për të justifikuar krijimin e pasurive, duke i kërkuar të paraqesë argumente/shpjegime përfundimtare, si dhe të depozitonte prova të reja të mundshme për të dokumentuar ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga aktiviteti tregtar i personit të lidhur në Bajram Curri, Tropojë.
19. Pas shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, në prapësime dhe në seancën dëgjimore, duke vërejtur se subjekti i rivlerësimit ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacion mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit për vitet 1994-1997, në qytetin e Bajram Currit, por nuk ka mundur të disponojë të dhëna konkrete për shkak të informacionit të cunguar të dërguar nga DRT-ja Kukës, e po ashtu të mungesës së informacionit nga institucione të tjera, me të cilat pretendon se bashkëshorti i saj ka pasur marrëdhënie financiare, Komisioni ka vlerësuar të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar informacion, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, pasi ka verifikuar dhe analizuar

²⁰ Përmes pyetësorit nr. 2.

²¹ Subjekti ka deklaruar shumat e investuara çdo vit, sipas informacionit të bashkëshortit: në periudhën gusht-dhjetor 1998 është investuar dhe ndërtuar rreth 1.000.000 lekë; në vitet 1999 dhe 2000 është investuar dhe ndërtuar nga 1.500.000 lekë në secilin vit; në vitin 2001 është investuar dhe ndërtuar rreth 1.000.000 lekë; në vitet 2002 dhe 2003 është investuar dhe ndërtuar nga 500.000 lekë në secilin vit.

pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi shumën e të ardhurave të fituara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit në raport dhe harmoni me provat e depozituara, legjislacionin fiskal, si dhe realitetin social-ekonomik të kohës, Komisioni ka vlerësuar të mos i japë vlerë provuese aktekspertimit të paraqitur prej subjektit si provë për të mbështetur pretendimet e saj. Duke referuar në kuadrin ligjor të kohës, për një qasje sa më garantuese në kryerjen e analizës financiare, Komisioni ka analizuar si rast hipotetik atë të realizimit të 10-fshit të qarkullimit vjetor për të cilin subjekti fizik “{***}” do të kishte detyrimin për të paguar tatimin minimal të parashikuar në ligjin nr. 7679/1993. Sipas kësaj përlllogaritjeje dhe duke konsideruar disa prej pretendimeve të subjektit, të analizuara në detaje në vijim, ka rezultuar fitimi *neto* në shumën rreth 5.000.000 lekë për aktivitetin tregtar të bashkëshortit për periudhën 1994-1997. Sipas kësaj qasjeje garantuese të Komisionit, ka rezultuar se përmbyset balanca negative e fondeve në momentin e blerjes së truallit mbi të cilin është ngritur godina, dhe se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimet e kryera në ndërtimin e pjesës takuese në godinën e banimit, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë²², duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, kundërshton konkluzionin e Komisionit me pretendime të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si vijojnë.
 - (i) Komisioni, megjithëse pranon se ka qenë në kushtet e pamundësisë për të siguruar dokumentacion zyrtar/dokumentacion ligjor për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, është kontradiktor lidhur me arsyetimin për shumën e të ardhurave nga aktiviteti tregtar, bindja e brendshme e Komisionit bie ndesh me provat e administruara dhe konkluzionet e aktekspertimit të paraqitur prej saj janë paragjykuar.
 - (ii) Të ardhurat nga aktiviteti i ligjshëm tregtar i bashkëshortit në periudhën 1994-1997, të deklaruara në deklaratën *vetting* në shumën 15.000.000 lekë, duke shpjeguar gjatë hetimit administrativ se aktiviteti tregtar i bashkëshortit nuk reduktohej në tregtimin me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë në njësinë ku ai zhvillonte këtë biznes, por edhe në furnizimin e enteve të ndryshme lokale e më gjerë, duke gjeneruar një normë fitimi të konsiderueshme, janë paragjykuar, duke u llogaritur prej Komisionit në shumën 5.000.000 lekë, pa pasur asnjë provë shkencore që të provonte të kundërtën e pretendimeve të saj.
 - (iii) Sipas subjektit, për shkak të moskryerjes së një hetimi të plotë e shterues prej Komisionit, detyrë ligjore e tij, për konstatimin e drejtë të gjendjes faktike, kërkohet riçelja e hetimit gjyqësor në funksion të marrjes së provës së re, aktekspertimit të paraqitur bashkëlidhur ankimit, *me konkluzione profesionalisht korrekte dhe më të besueshme në kuptim të ligjit*.
 - (iv) Referenca e Komisionit në përcaktimet e nenit 3, germa “gj” e ligjit nr. 7679/1993, duke përcaktuar një normë fitimi prej 6%, është tërësisht e gabuar dhe me qëllim uljen maksimalisht të volumit të të ardhurave të aktivitetit tregtar të bashkëshortit në vitet 1994-1997, dhe qasja e ofruar prej tij në përcaktimin e këtyre të ardhurave nuk është aspak garantuese, por rëndon në mënyrë të pajustificuar pozitën e saj.

²² Konkretisht, balancat negative të rezultuara janë si vijojnë: për periudhën 1992-2003 në shumën (-) 4.621.892 lekë; për vitin 2007 në shumën (-) 157.813 lekë; për vitin 2008 në shumën (-) 395.222 lekë; për vitin 2009 në shumën (-) 98.795 lekë; për vitin 2011 në shumën (-) 174.740 lekë.

(v) Kolegji duhet të marrë në konsideratë të favorshme për të punën e bashkëshortit në grumbullimin dhe shitjen e bimëve mjekësore për periudhën 1997 - 2000, në bashkëpunim me firmën “{***}” në Elbasan, me të ardhura në shumën 3.000.000 lekë, duke punuar i palicencuar pasi nuk funksiononte shteti, arsye për të cilën nuk janë deklaruar të ardhura për këtë periudhë, dhe për këtë fakt ka depozituar deklaratën noteriale të shtetasit Y. Sh., me nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 21.06.2022.

21. Trupi gjykues, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të kontrollit të përfundimit të Komisionit për këtë pasuri, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, arriti në përfundimet e mëposhtme.

21.1. Subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti tregtar i personit të lidhur, bashkëshortit A. M. (H.), për periudhën 1994-1997, në qytetin e Bajram Currit.

21.2. Në këtë aspekt, ku sipas Komisionit është vlerësuar i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar informacion mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, për periudhën e sipërcituar, duke sjellë si pasojë aplikimin e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për verifikimin dhe analizimin e pretendimeve të subjektit mbi shumën e të ardhurave të fituara nga aktiviteti tregtar në raport dhe harmoni me provat e depozituara, legjislacionin fiskal, si dhe realitetin social-ekonomik të kohës.

21.3. Në rrethanat faktike dhe ligjore të rezultuara nga aktet në dosje, trupi gjykues vlerëson të drejtë e të bazuar referimin prej Komisionit në përcaktimet e ligjit nr. 7679/1993, në funksion të përcaktimit të qarkullimit të mundshëm vjetor dhe për periudhën 1994-1997, të subjektit tregtar “{***}”, nga aktiviteti tregtar në qytetin e Bajram Currit, si dhe qasjen garantiste të shpërfaqur përmes analizimit të një qarkullimi vjetor dhe fitimi neto që do t’i korrespondojnë pagesës së 10-fishuar të detyrimit minimal tatimor të përcaktuar në ligj, si një rast i mundshëm hipotetik. Në çdo opsion të konsideruar mbi situatën faktike dhe legjislacionin e identifikuar, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provojnë të kenë pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimet e kryera në ndërtimin e pjesës takuese të familjes së saj në këtë pasuri.

21.4. Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i grumbullimit dhe shitjes së bimëve mjekësore për periudhën 1997 - 2000, për të cilin subjekti deklaroi se bashkëshorti A. M. (H.) nuk ka qenë i licencuar për ushtrimin e tij, përpos se deklarative dhe të paprovuara, trupi gjykues vlerëson se, në referim të deklaratimeve të vetë subjektit, ato nuk do të kënaqnin në çdo rast as kriteret kushtetuese dhe ligjore për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në vijim, analiza dhe vlerësimi i trupit gjykues.

Lidhur me pretendimet e subjektit mbi shumën e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i personit të lidhur, bashkëshortit A. M. (H.), për periudhën 1994-1997, në qytetin e Bajram Currit

22. Subjekti i rivlerësimit, duke referuar në shkresën e DRT-së Kukës nr. {***} prot., datë 23.05.2022, drejtuar Komisionit, dhe aktet bashkëlidhur saj, pretendon se përmes këtyre akteve me fuqi të plotë provuese, provohet fakti që bashkëshorti ka ushtruar aktivitet tregtar si person fizik prej datës 09.03.1994, është çregjistruar më datë 10.04.1997, se gjatë periudhës së ushtrimit të këtij aktiviteti janë paguar rregullisht detyrimet tatimore vjetore dhe ato të Bashkisë Bajram Curri. Sipas subjektit, fakti që legjislacioni i kohës nuk parashikonte deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, por vetëm pagimin e një tarife fikse, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi.

22.1. Trupi gjykues, së pari, sjell në vëmendje se ushtrimi prej bashkëshortit të subjektit i aktivitetit tregtar si person fizik në qytetin Bajram Curri, Tropojë, prej marsit 1994 sipas vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Tropojë, deri në prill 1997, kur çregjistrohet si i tillë po me vendim të kësaj gjykate, me kërkesën e tij, si dhe shlyerja e detyrimeve për këtë periudhë, janë fakte që Komisioni i ka njohur, bazuar në informacionin dhe aktet e përcjella prej DRT-së Kukës, administruar në dosjen gjyqësore. Për rrjedhojë, shpjegimet/pretendimet e subjektit lidhur me fuqinë provuese të akteve të sipërcituara për faktin se bashkëshorti i saj ka ushtruar aktivitet tregtar aktiv, vlerësohen të tejkaluara dhe pa ndikim në çështjen objekt shqyrtimi, duke qenë se edhe Komisioni e ka pranuar si të provuar këtë fakt.

22.2. Referuar shkresës dhe akteve të përcjella nga DRT Kukës bashkëlidhur, të cituara prej subjektit, sikundër Komisioni ka konstatuar, mungojnë të dhëna mbi masën e tatimit të paguar, referuar të cilit mund të përllogaritet qarkullimi i realizuar sipas parashikimeve të ligjit të kohës, dhe përafërsisht fitimi *neto* sipas një norme fitimi të pranueshme. DRT-ja Kukës, në shkresën e saj, informon: [...] *Për sa i përket fitimit neto të realizuar nga subjekti në atë periudhë, nuk ka pasur deklarime mbi të ardhurat dhe shpenzimet, por janë tatuar me tarifa fikse apo me përqindje xhiroje dhe se është e pamundur prej tyre të përcaktohet saktë fitimi neto i realizuar sipas viteve kalendarike [...]*. Sipas këtij informacioni, rezulton se në periudhën në fjalë, është aplikuar si rregull tatim me tarifë fikse apo përqindje xhiroje, ndërkohë subjekti, në ankim, pretendon se nga kjo shkresë provohet se: *është paguar tarifë fikse*, pretendim i paraqitur prej saj edhe në Komision. Ndërsa në parashtrimet në Kolegj, subjekti ndryshon qëndrim dhe pretendon: [...] *bashkëshorti, duke pasur një xhiro të madhe asnjëherë nuk ka paguar tatimin minimal 50.000 lekë në vit, por është tatuar në mënyrë proporcionale me të ardhurat e realizuara [...]*. Për sa më sipër, konstatohet një mungesë konsistence prej subjektit lidhur me mënyrën dhe metodologjinë e përcaktimit të tatimit të paguar, për të cilin bashkëshorti i saj ka qenë në dijeni të plotë, e cila vlerësohet jo vetëm në drejtim të besueshmërisë së deklarimeve të saj, por edhe në përcaktimin e vlerës provuese të provës – *aktekspertimi* – të dorëzuar prej saj në Komision, në të cilin nuk gjendet asnjë përllogaritje dhe ngarkim me shpenzim në analizën financiare, të vlerës së tatimit që duhej të ishte paguar për aktivitetin.

22.3. Gjithashtu, siç është arsyetuar më lart, sipas Komisionit, është vlerësuar i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar informacion mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, për periudhën 1994-1997, duke e vendosur atë në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisioni, përkundrejt një vlerësimi me vlerën zero që do të kishte bërë në versionin që subjekti nuk gjendej në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka zhvilluar një analizë

të arsyeshme për verifikimin e pretendimeve të subjektit mbi shumën e të ardhurave të fituara nga aktiviteti tregtar, të mbështetur nga aktekspertimi i paraqitur, duke e vlerësuar atë në raport dhe harmoni me provat e depozituara, legjislacionin fiskal, si dhe realitetin social-ekonomik të kohës, i cili bazohet në parashikimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, qëndrimi i Komisionit për të analizuar dhe vlerësuar provën e paraqitur prej subjektit për të mbështetur pretendimet lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit – *aktekspertimin* – në raport me të gjitha rrethanat e përmendura më sipër, vlerësohet nga trupi gjykues, i drejtë. Në vlerësimin e trupit gjykues, Komisioni nuk mund të pranonte apriori deklaratimet e subjektit për sasinë e të ardhurave të aktivitetit, vetëm pse ajo gjendej në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, por ai duhej të vlerësonte besueshmërinë e këtyre deklaratimeve brenda logjikës së të gjitha fakteve e standardeve ligjore që kanë rezultuar lidhur me rastin konkret, veprimtari e cila është ushtruar prej Komisionit në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore.

22.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në arsyetimin e vendimit të Komisionit, *janë anashkaluar konkluzionet me karakter teknik profesional ekonomik të ekspertit me njohuri të posaçme A. Ç.*, pa ngritur asnjë pretendim apo pa dhënë asnjë shpjegim lidhur me shkaqet për të cilat Komisioni ka vlerësuar të mos i japë fuqi provuese aktekspertimit të administruar si provë, të cilat analizohen gjerësisht në vendimin objekt shqyrtimi. Konkretisht, subjekti mjaftohet me deklarinë se për aktivitetin “Shitje artikujsh të ndryshëm – market “{***}”, person fizik për periudhën mars 1994 deri në dhjetor 1997”, eksperti, pasi ka *përgatitur metodat alternative për përllogaritjen e fitimit*, arrin në përfundimet për të ardhura të realizuara prej 104.375.000 lekësh, fitimin bruto me një marzh fitimi prej 20%, në vlerën 20.875.000 lekë, shpenzime të kryera 5.475.000 lekë, fitimi i mbetur *neto* 15.400.000 lekë. Në vijim, shpjegon se ka kërkuar që ky dokument të vlerësohet prej Komisionit si një aktekspertim privat, citon qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin nr. {***}, datë 04.06.2013, si dhe qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij²³, sipas saj, në një rast identik me të sajën ku, duke u mbështetur vetëm në aktekspertimin privat për llogaritjen e të ardhurave, të cilat kanë qenë në nivel deklarativ, i ka bërë ato pjesë të analizës financiare. *Së pari*, trupi gjykues vlerëson se qëndrimi i mbajtur prej Gjykatës së Lartë: [...] *do të ishte non-sens juridik ndalimi, ose mospranimi, apo mosnënshtrimi i debatit gjyqësor të një opinioni shkencor që paraqitet nga pala ndërgjyqëse, qoftë edhe të një aktekspertimi “privat” të përgatitur nga një ekspert i licencuar rregullisht për atë fushë, me të cilin ajo palë synon të provojë pretendimin kryesor të saj [...]*, ndonëse i referohet një procesi gjyqësor civil me tipare të pastra kontradiktorialiteti, ka gjetur zbatim edhe në mënyrën se si Komisioni ka analizuar provën aktekspertimi të paraqitur prej subjektit. Në parashtrimet në Komision, lidhur me aktekspertimin që ka paraqitur me to, subjekti shpreh *se depoziton një provë të re*²⁴, duke kërkuar të njihen të ardhurat e ligjshme të përfituara nga biznesi i bashkëshortit në shumën 15.400.000 lekë, të deklaruara prej saj në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ, të cilat manifestohen edhe në përllogaritjet e ekspertit kontabël. Komisioni e ka pranuar si provë aktekspertimin, e ka shqyrtuar paraprakisht, ia ka nënshtruar debatit në seancën dëgjimore dhe ka arsyetuar gjerësisht në vendim lidhur me shkaqet për të cilat ka vlerësuar të mos i japë vlerë provuese. *Së dyti*, në vendimin e Kolegjit, referuar prej

²³ Subjekti referon vendimin e Kolegjit nr. 20 (JR), datë 14.06.2022, duke cituar pjesë të paragrafit 13.16, si dhe paragrafët 13.18 dhe 13.20 të tij.

²⁴ Shih faqet 29 dhe 35 të parashtrimeve të subjektit.

subjektit, në të kundërt sa pretenduar, situata nuk është e njëjtë si në rastin objekt shqyrtimi. Konkretisht, në vendimin e Kolegjit, shtjellohet qartë, përveç se Komisioni nuk i kishte kaluar subjektit barrën e provës për të ardhurat objekt shqyrtimi, Kolegji ka vlerësuar mbajtjen në konsideratë të përlllogaritjeve në aktin “Raport vlerësimi”, të përgatitur nga një eksperte e licencuar, të mbështetur mbi baza shkencore, *lehtësisht të aksesueshme nga burime të hapura* e, për më tepër, referuar legjislacionit të zbatueshëm, nuk ka evidentuar dispozita ligjore që të kategorizojnë të ardhurat në fjalë si të tatueshme, të cilat mbeteshin në nivel deklarativ për sa nuk shoqëroheshin me dokumentacion të plotë financiar-kontabël. Në rastin e subjektit, aktekspertimi i paraqitur si provë për të mbështetur pretendimet mbi të ardhura nga aktiviteti tregtar, të tatueshme sipas legjislacionit të kohës, në kushtet kur organet tatimore nuk disponojnë të dhëna për të ardhurat prej tij, mbështetet vetëm në deklarime të bashkëshortit të subjektit, e në asnjë provë shkencore të identifikueshme. Sa më sipër, pretendimet e subjektit vlerësohen të pabazuara.

22.5. Në vijim të pretendimeve si më lart, subjekti sjell në vëmendje se, mbështetur në provat e administruara, *aktekspertimin privat*, nenet 214, 253 dhe 254 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe vendime të Kolegjit, ka kërkuar që Komisioni të bëjë pjesë të analizës financiare të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit në “Shitje artikuj të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë me shumicë e pakicë - market “{***}”, person fizik për vitet 1994-1997”, por, pasi ka marrë në analizë të gjitha provat, Komisioni ka vlerësuar se vlera e fitimit *neto* do të ishte në shumën rreth 5.000.000 lekë, dhe jo sa përmendur në aktekspertimin privat. Në kuadër të këtij pretendimi, konstatohet se në aktet e përcjella nga DRT Kukës, përfshihet edhe kopja e vendimit të Gjykatës së Rrethit Tropojë, datë 10.04.1997, “Për çregjistrimin si person fizik privat”, në përmbajtje të të cilit pasqyrohet se: *kërkuesi A. H., me vendimin nr. {***}, datë 10.03.1994, të po kësaj gjykate, është njohur si person fizik në fushën e tregtimit të produkteve ushqimore të gatshme e të ambalazuara*, se deri në datë 10.04.1997, ka shlyer rregullisht të gjitha detyrimet shtetërore e nuk është debitor, dhe kërkon të çregjistrohet si person fizik në këtë fushë. Në dispozitivin e vendimit, gjykata shprehet për çregjistrimin e personit fizik A. H. dhe: *të mos ushtrojë privatisht profesionin në fushën e tregtimit të produkteve ushqimore, të gatshme dhe të ambalazuara, si individ, në qytetin e Bajram Currit, duke humbur të drejtën e personit fizik privat*. Gjithashtu, referuar kopjes së vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Tropojë, datë 9.03.1994, vërtetohet se, me vendimin e po kësaj date të gjykatës, z. A. M. është njohur si person fizik privat, si shitës i artikujve të ndryshëm. Në kopjet e certifikatave të regjistrimit në organin tatimor të personit fizik “{***}”, pasqyrohet si vend ushtrimi i veprimtarisë lokale në lagjen “{***}” në Bajram Curri, dhe objekt veprimtarie tregtim i artikujve të ndryshëm ushqimorë e industrialë. Gjithashtu, referuar kopjes së planimetrisë së lokalit “Për Degën e Tatimeve dhe Taksave Tropojë”, nënshkruar dhe vulosur për Zyrën e Urbanistikës së qytetit, pasqyrohet planimetria e lokalit (ushqimore) dhe sipërfaqja përlllogaritet 32,3 m². Referuar akteve të sipërcituara, nuk rezulton asnjë e dhënë që personi fizik “{***}” të ketë kryer aktivitet tregtar me shumicë. Për më tepër, subjekti pretendon se bashkëshorti ka pasur kontrata furnizimi vijuese me Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik Tropojë, e cila furnizonte me produkte ushqimore dhe artikuj industrialë, si: batanije, jastëkë, çarçafë etj., tri spitale, si atë të Bajram Currit, Tropojës e spitalin Dushaj, si dhe të gjitha qendrat shëndetësore të rrethit Tropojë, si dhe Komisariatit të Policisë Tropojë, i cili furnizonte me artikuj të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë të gjitha pikat kufitare të rrethit, në varësi të tij. Konsideruar

sipërfaqen e lokalit prej 32 m², në të cilin ushtrohej aktiviteti tregtar, duket e vështirë kryerja e veprimtarisë tregtare për shitjen më shumicë të artikujve të cituar, si për llojin e tyre, ashtu edhe për volumin e pretenduar të shitjeve, sipas numrit të institucioneve të përmendura prej subjektit. Shpjegimet e subjektit se për shitjet me shumicë, artikujt e porositur paraprakisht dërgoheshin te porositësi pa u magazinuar, dhe se bashkëshorti lëvronte mallrat me kamionin e të vëllait, nuk duken bindëse, referuar volumit të pretenduar të artikujve, vështirësive të transportit, shkaktuar prej rrjetit rrugor të amortizuar të kohës, distancave të largëta etj. Trupi gjykues, pavarësisht se më lart në këtë vendim ka analizuar dhe vlerësuar të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos i dhënë fuqi provuese aktekspertimit, në vijim të tyre, çmoi t'i pasqyrojë konstatimet si më sipër, në funksion të një analize të detajuar të pretendimeve të subjektit për ushtrimin e tregtisë me shumicë/volumit të saj, me ndikim në rritjen e xhiros së aktivitetit tregtar të bashkëshortit, sipas subjektit. Rrethanat faktike dhe ligjore të sipëranalizuara krijojnë bindjen për pabazueshmërinë e pretendimeve të subjektit lidhur me volumin e aktivitetit tregtar të bashkëshortit me institucionet shtetërore. Për rrjedhojë, pamundësia objektive për sigurimin e informacionit, pasi Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik Tropojë dhe Komisariati i Policisë Tropojë, përmes shkresave përkatëse, informojnë për dëmtime të arkivave apo djegie të tyre në ngjarjet e vitit 1997 dhe Raiffeisen Bank përgjigjet se nuk ka asnjë mundësi për vënie në dispozicion të informacionit për veprime në llogarinë e A. M., nuk mund të deduktojë edhe hipotetakisht, se një informacion prej tyre do të zhbënte bindjen e krijuar mbi bazë të analizës së të dhënave të administruara, se është e vështirë të besohet realizimi i të ardhurave të pretenduara prej 104.375.000 lekësh në një periudhë trevjeçare, të shtrirë në vitet 1994-1997, në kushtet kur është zhvilluar ky aktivitet tregtar.

22.6. Në ankim, subjekti pretendon që të ardhurat e deklaruara/prenduara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit t'i mbështesë me një aktekspertim tjetër²⁵, paraqitur bashkëlidhur, pjesë të të cilit, bashkë me përfundimet e tij, i referon në ankim dhe në parashtrime. Për rrjedhojë, pavarësisht se aktekspertimi i paraqitur me ankimin nuk u pranua si provë për gjykimin në Kolegj, pretendimet e subjektit, bazuar në përfundimet e tij, u morën në shqyrtim prej trupit gjykues në gjykimin e çështjes.

22.7. Subjekti pretendoi se: *[...] në funksion të provueshmërisë së veprimeve të kryera dhe konkluzioneve profesionale të arritura prej ekspertit, pavarësisht veçorive specifike që paraqet ky rast, është shfrytëzuar një dokumentacion i bollshëm në formën e kërkuar nga ligji, akte të cilat i janë bashkëlidhur raportit [...].* Aktet që subjekti i liston në ankim, rezultojnë të administruara në fashikujt e Komisionit e, në bazë të tyre, rezultojnë të jetë përpiluar edhe aktekspertimi i paraqitur si provë në Komision. Sikundër ka konstatuar Komisioni dhe sikundër edhe vetë subjekti e pohon, këto akte nuk japin të dhëna lidhur me qarkullimin, tatimin e paguar apo fitimin e realizuar prej aktivitetit tregtar. Në listën e dokumentacionit të pasqyruar prej subjektit, në fund citohet: *[...] Gjithashtu, janë marrë informacione nga INSTAT dhe burime të tjera mbi numrin e banorëve të Bajram Currit, komunave të rrethit Tropojë për periudhën 1991-1997, dhe më pas mbi indeksin e çmimeve të konsumatorit, çmimet e tregut të mallrave të shportës dhe jo vetëm, si dhe janë kryer anketime të ndryshme mbi çmimet e blerjes dhe çmimet e shitjes së disa prej produkteve bazë për atë periudhë [...].* Përkundër kësaj sate që prezanton subjekti, konstatohet se në kryerjen e analizës, eksperti është bazuar në deklaratat e

²⁵ Përpiluar nga eksperti J. N.

bashkëshortit të subjektit, duke pohuar se nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga z. A. M., nuk mund të identifikohet saktësisht volumi i të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti privat, por është e mundur të identifikohet ushtrimi i një aktiviteti tregtar, kryesisht në fushën e tregtimit të artikujve ushqimorë. Të dhënat prej INSTAT-it²⁶, të përmendura në aktekspertim, nuk rezultojnë të kenë ndikuar në analizën e ekspertit, të mbështetur tërësisht në deklaratimet e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, ashtu si edhe në aktekspertimin e paraqitur në Komision. Për rrjedhojë të sa më sipër, aktekspertimi bashkëlidhur ankimit nuk ofron nivel provueshmërie të një shkalle të ndryshme nga aktekspertimi i paraqitur si provë në Komision. Në vijim, konstatohet se në të dy aktekspertimet, ai i depozituar në Komision²⁷ dhe ai bashkëlidhur ankimit²⁸, përllogariten të njëjta vlerat e qarkullimit dhe të fitimit të realizuara prej personit fizik “{***}”, në periudhën 1994-1997, qarkullimi 104.375.000 lekë dhe fitimi *neto* rreth 15.400.000 lekë, pavarësisht se ndryshimet sa i përket mospërfshirjes/përfshirjes së tatimit si shpenzim, logjikisht duhet të kishin sjellë përfundime të ndryshme. Për rrjedhojë, konstatohet se aktekspertimi i depozituar me ankimin, përmes ndryshimeve në shpërndarjen e shpenzimeve, ka përfshirë tatimin me tarifë proporcionale si shpenzim, thënë ndryshe, ka korrigjuar disa prej të metave të aktekspertimit të çmuar pa vlerë provuese prej Komisionit.

22.8. Sa më sipër, në çdo këndvështrim, pretendimet e subjektit për qarkullimin prej 104.375.000 lekësh dhe fitimin *neto* prej 15.000.000 lekësh nga aktiviteti tregtar i personit të lidhur, bashkëshortit A. M. (H.), për periudhën 1994-1997, në qytetin e Bajram Currit, mbeten deklarative, të pabazuara në akte dhe prova. Në kuptim të detyrimeve të buruara nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, konkretisht të shpjeguarit bindshëm të të ardhurave të ligjshme dhe të burimit të ligjshëm të pasurisë, mospërfshirja në aktekspertim si shpenzim e tatimeve, ku dokumentacioni provues për shlyerjen e tyre referohet me forcë prej subjektit si përcaktues për ligjshmërinë e të ardhurave, çmohet prej trupit gjykues si përpjekje e subjektit për të mbështetur pretendimet për ligjshmërinë e të ardhurave me prova pa fuqi provuese, në mosplotësim të detyrimeve të sipërcituara. Gjithashtu, paraqitja e një aktekspertimi të dytë, në një moment procedural në tejkalim të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, me plotësim të një prej të metave thelbësore të të parit, mosbazueshmërinë në legjislacionin e kohës, por pa e cenuar fitimin *neto* në konkluzionin e tij, dëshmon përpjekje të sforcuara të subjektit për të ruajtur me çdo kusht, konkluzionin mbi vlerën totale të të ardhurave si një kusht i domosdoshëm për të justifikuar vlerën e pasurisë të marrë në analizë.

Lidhur me pretendimet mbi qëndrimin garantues të Komisionit mbi shumën e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit

23. Komisioni, për një qasje garantiste në kryerjen e analizës financiare, në vlerësimin përfundimtar lidhur me shumën e të ardhurave të përfituara nga personi i lidhur si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar në qytetin e Bajram Currit, ka marrë të mirëqenë se: (i) aktiviteti

²⁶ Referuar Vjetarit Statistikor të vitit 1991, publikuar nga INSTAT.

²⁷ Përpiluar sipas kërkesës së z. A. M. për pyetjen: “[...] në kushtet kur aktiviteti i individëve në periudhën mars 1994 - dhjetor 1997, nuk ka qenë detyrim ligjor për hartimin e bilancit ekonomik e financiar, a ka mundësi të evidentohet fitimi bruto dhe fitimi neto që kam pasur për këto periudha [...]”.

²⁸ Përpiluar sipas kërkesës së z. A. M. për: “[...] një raport ekspertimi për të llogaritur dhe vlerësuar fitimin neto gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit në fushën e tregtisë së mallrave ushqimore dhe industriale, si subjekt tregtar me përgjegjësi tatimore “Subjekt i tatimit mbi qarkullimin”, me emrin tregtar “{***}” - person fizik, kod fiskal nr. {***}, për periudhën mars 1994 - dhjetor 1997 [...]”.

tregtar është ushtruar për 4 vite të plota, për periudhën 1994 -1997; (ii) personi i lidhur ka kryer aktivitet tregtie me pakicë dhe shumicë; dhe se (iii) norma e fitimit ka qenë rreth 15%, kjo në kushtet kur në aktekspertim është pranuar një normë fitimi prej 20%, por pa pasqyruar/reflektuar shpenzime të kryera për pagesën e tatimit mbi xhiron, që do të thotë praktikisht se ka pranuar të njëjtën normë fitimi sa ajo e pretenduar prej subjektit.

23.1. Lidhur me verifikimin e qarkullimit të mundshëm/të pranueshëm të realizuar nga subjekti tregtar “{***}”, në një vlerësim alternativ dhe sa më objektiv të rrethanave të përfituara gjatë hetimit administrativ, në kushtet që ka rezultuar e provuar se personi fizik “{***}” nuk ka pasur detyrime tatimore të papaguara në momentin e çregjistrimit, Komisioni u është referuar përcaktimeve në ligjin nr. 7679/1993, ku në germën “gj” të nenit 3 parashikohet se masa e tatimit për tregtarët që bëjnë tregti me shumicë, të çdo lloji, është 6% e të ardhurave, por jo më pak se 50.000 lekë/vit. Vlerësuar kjo pagesë minimale prej 50.000 lekësh/vit, në raport me përqindjen e pagesës së tatimit mbi qarkullimin për këtë aktivitet, ka rezultuar se i përgjigjet një qarkullimi vjetor prej 833.333 lekësh (50.000 lekë përbëjnë 6% të shumës 833.333 lekë). Në kuadër të mbajtjes së një qasjeje sa më garantuese, Komisioni ka analizuar rastin hipotetik të realizimit të 10-fishit të qarkullimit vjetor për të cilin subjekti fizik të kishte detyrimin për të paguar shumën 50.000 lekë. Në këtë opsion, personi fizik do të kishte paguar 10-fishin e detyrimit minimal tatimor, qarkullimi vjetor do të ishte 8.333.333 lekë, për periudhën 1994-1997 qarkullimi do të ishte 33.333.332 lekë dhe fitimi *neto* 5.000.000 lekë, në aplikim të normës së fitimit prej 15% të pranuar prej Komisionit. Në këtë vlerë hipotetike është bazuar kryerja e analizës financiare prej Komisionit.

- 24.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se referenca në përcaktimet e nenit 3, germa “gj” e ligjit nr. 7679/1993, duke përcaktuar një normë fitimi 6%, është tërësisht e gabuar, me qëllim uljen maksimalisht të volumit të të ardhurave. Sipas subjektit, qasja e ofruar prej Komisionit jo vetëm nuk është garantuese, por ka rënduar në mënyrë të pajustificuar pozitën e saj sa u përket të ardhurave të ligjshme në vite. Sipas saj, prej ekspertit J. N., në mënyrë profesionale e proporcionale, është marrë në konsideratë një marzh mesatar fitimi prej 14,8%, duke iu referuar të gjitha të dhënave të siguruara në mënyrë të ligjshme për atë periudhë kohe, njëherazi duke respektuar faktorët socialë, ekonomikë dhe historikë për këtë konkluzion. Në vija të përgjithshme, subjekti i rivlerësimit pretendoi se *përlllogaritja e fitimit pa dokumentacionin e duhur nga palët, por vetëm duke cituar ligjin, është e pamundur*, prandaj thirri për zbatim konkluzionet e aktekspertimit të paraqitur me ankimin.

24.1. Trupi gjykues, *së pari*, konstaton se Komisioni ka referuar se 6% e të ardhurave është masa e tatimit për tregtarët që bëjnë tregti me shumicë, të çdo lloji, sipas parashikimeve të ligjit, dhe jo se 6% është norma e fitimit, sikundër pretendon subjekti. *Së dyti*, gjen të drejtë e të bazuar analizën e Komisionit se, referuar legjislacionit të kohës²⁹, rezulton se nuk është e qartë ndarja e bizneseve dhe përgjegjësia tatimore e tyre, në dukje përgjegjësia tatimore përcaktohet nga statusi i regjistrimit si person fizik apo juridik dhe, në këtë kuptim, rezulton se

²⁹ Ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”; ligjin nr. 7677, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi fitimin”; ligjin nr. 7676, datë 2.3.1993, “Për tatimin mbi qarkullimin”; ligjin nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”; dhe ligjin nr. 7681, datë 4.3.1993, “Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”.

personat fizikë trajtoheshin nga ligji nr. 7679/1993³⁰, pavarësisht qarkullimit të kryer prej tyre³¹. *Së treti*, në këtë aspekt, pavarësisht kuadrit ligjor të cituar prej subjektit në ankim, me të cilin, sipas saj, janë harmonizuar konkluzionet e akteksptimit të dytë, i cili është kryesisht ai i referuar prej Komisionit, subjekti nuk ngre ndonjë pretendim se një parashikim tjetër ligjor do të duhej të aplikohet apo është aplikuar realisht për përcaktimin e përgjegjësisë tatimore që vinte nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të bashkëshortit të saj. *Së katërti*, referimi në përcaktimet e ligjit nr. 7679/1993, i cili nuk parashikonte deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, por përcaktonte pagesën e tatimit bazuar në qarkullimin, si ligji i aplikueshëm për verifikimin e qarkullimit të mundshëm/ të besueshëm, të realizuar nga subjekti tregtar “{***}”, vjen në përputhje edhe me deklarimin e subjektit në parashtrimet në Komision: [...] *bashkëshorti im ka deklaruar dhe dorëzuar çdo vit në Zyrën e Tatimeve Tropojë, xhiron, tatimet dhe taksat e paguara, sikurse e detyronte ligji i kohës [...] dhe, si i tillë, identifikohet vetëm ligji nr. 7679/1993. Së pesti*, në kushtet kur aktet e përcjella nga DRT-ja Kukës nuk japin të dhëna mbi tatimin e paguar nga personi fizik “{***}”, referimi në ligjin nr. 7679/1993, nenin 3, germën “gj” të tij, ku parashikohet masa e tatimit për tregtarët që bëjnë tregti me shumicë, të çdo lloji, sa 6% e të ardhurave, por jo më pak se 50.000 lekë/vit, është opsioni i vetëm, i bazuar, për përllogaritjen e një qarkullimi të realizuar/të pranueshëm. Konkretisht, Komisioni ka kryer përllogaritje bazuar në masën e tatimit në vlerën minimale të detyrueshme prej 50.000 lekësh/vit, si dhe duke e 10-fishuar atë. Për rrjedhojë, vlerat e rezultuara të qarkullimit dhe fitimit për aktivitetin tregtar me shumicë, si një aktivitet që gjeneron më shumë fitim se ai me pakicë, pra në një qasje favorizuese për subjektin, janë përcaktuar në opsionin e pagesës minimale të detyrueshme të tatimit, por edhe në opsionin hipotetik të pagesës së 10-fshit të saj. Në vlerën e përllogaritur të qarkullimit të mundshëm sipas opsionit të dytë hipotetik, është aplikuar norma e fitimit e pranuar prej Komisionit në referim të asaj të aplikuar në akteksptimin e administruar, e cila rezulton e përafërt me normën e fitimit në akteksptimin e ekspertit J. N. Nëse Komisioni do të duhej të kishte pranuar pretendimet e subjektit pa asnjë referim në ligj, vlerësimi do të ishte krejtësisht subjektiv dhe pa asnjë bazë të qëndrueshme e objektive mbi të cilën të llogariteshin të ardhurat.

25. Në vlerësimin e qëndrimit të mbajtur nga Komisioni, trupi gjykues pati në konsideratë edhe disa përcaktime të ligjit nr. 7679/1993, i ndryshuar me Dekretin e Presidentit të Republikës me nr. 1486, datë 6.5.1996, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, sipas të cilit do të trajtoheshin nga përgjegjësia tatimore e biznesit të vogël të gjithë personat fizikë apo juridikë që nuk ishin subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar dhe që realizonin qarkullim vjetor deri në vlerën prej 2.000.000 lekësh. Këto ndryshime duket se kanë qenë të aplikueshme për aktivitetin tregtar të bashkëshortit të subjektit të paktën që prej vitit 1996, kur kanë hyrë në fuqi, por që gjithsesi japin një panoramë të trendit të vlerave të qarkullimit, të cilat mund/duhet të konsideroheshin brenda një fashe të caktuar tatimore. Sipas këtij leximi, jo vetëm pas hyrjes në fuqi të këtyre parashikimeve, por, me gjasa, edhe para tyre, qarkullime me vlera vjetore më të larta se 2.000.000 lekë, së pari, nuk duhej se realizoheshin

³⁰ Ligji nr. 7679, datë 3.03.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, është shfuqizuar me ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998.

³¹ Me Dekretin e Presidentit të Republikës me nr. 1486, datë 6.5.1996, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, neni 1 i ligjit nr. 7679/1993 ndryshon si vijon: “Të gjithë personat fizikë e juridikë që kryejnë apo do të kryejnë një qarkullim më të vogël se 2.000.000 lekë në një vit kalendarik dhe që nuk janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar, i nënshtrohen tatimit mbi biznesin e vogël”.

nga aktiviteti i personave fizikë, por edhe nuk konsideroheshin si biznes i vogël, për pasojë ata do të përfshiheshin në një regjim tjetër tatimor, i cili diktonte të tjera përgjegjësi në raport me vlerën e tatimit dhe të tjera mekanizma për përcaktimin e tij. Me fjalë të tjera, të paktën pas vitit 1996, bashkëshorti i subjektit nuk mund ligjërisht të realizonte qarkullim më të madh se vlera 2.000.000 lekë, përndryshe do të duhej të përfshihej në tjetër regjim tatimor, për pasojë, vlerësimi që ka bërë Komisioni për vlera më larta qarkullimi, 8.333.332 lekë në vit, vlerësohet si garantist dhe i arsyeshëm. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për analizë të gabuar të Komisionit për përcaktimin e të ardhurave mbi metodologjinë e arsyetuar më sipër, vlerësohen prej trupit gjykues, të pabazuara.

26. Përpos faktit se Komisioni ka përfshirë në analizën financiare qarkullimin vjetor dhe fitimin neto që do t'i korrespondojnë pagesës së 10-fishuar të detyrimit minimal tatimor të përcaktuar në ligj, si një rast i mundshëm hipotetik, çka përbën një qëndrim tejet garantist, rezulton se për kryerjen e analizës financiare, Komisioni ka marrë në konsideratë pretendime të subjektit, konkretisht se: (i) pas çregjistrimit të personit fizik “{***}”, me vendimin e gjykatës, datë 10.04.1997, meqenëse dyqani kishte inventar të trashëguar nga periudhat e mëparshme, kanë vijuar përpjekjet për shitjen e artikujve gjendje, kështu që në fakt të ardhurat janë marrë deri në fund të vitit 1997; (ii) bashkëshorti ka kryer edhe aktivitet tregtie me shumicë; si dhe (iii) duke referuar në normën e fitimit të aktekspertimit të paraqitur prej subjektit, me korigjim të saj për shpenzime të papërfshira – tatimet e paguara – ka aplikuar normë tatimi në masën 15%, të përafërt me normën e fitimit prej 14,8% të aplikuar në aktekspertimin e dytë.
27. Sa më sipër, në kushtet kur, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, rezulton se në çdo opsion të konsideruar mbi situatën faktike dhe legjislacionin e identifikuar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provojnë të kenë pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimet e kryera në ndërtimin e pjesës së tyre takuese në këtë pasuri, pretendimet e subjektit për të konsideruar *konkluzionet bindëse të ekspertëve të pasqyruara në aktekspertimet përkatëse*, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara.
28. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson të drejtë e të bazuar referimin prej Komisionit në përcaktimet e ligjit nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, në funksion të përcaktimit të qarkullimit vjetor dhe, në total, për periudhën 1994-1997, të subjektit tregtar “{***}”, nga aktiviteti tregtar në qytetin e Bajram Currit, si dhe qasjen garantiste të kryer përmes analizimit të një qarkullimi vjetor dhe fitimi neto sa 10-fishi i qarkullimit vjetor, të cilit do t'i korrespondojë detyrimi minimal tatimor i përcaktuar në ligj, si një rast i mundshëm hipotetik.
29. Lidhur me me të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i grumbullimit dhe shitjes së bimëve medicinale për periudhën 1997-2000, për të cilat i vetmi dokument i paraqitur prej subjektit në Komision është deklarata noteriale nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 21.06.2022, e shtetasit Y. Sh., konstatohet dhe vlerësohet si vijon. Referuar deklaratës *vetting*, për pasurinë “shtëpi banimi 3 kate+ papafingo”, për burimin e krijimit të ardhura nga *ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortit A. H. (M.)* deklarohet edhe “1997-2001 grumbullim dhe shitje bimë medicinale” pa deklaruar vlerë. Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, si burim krijimi të pasurisë subjekti deklaroi të ardhurat nga *aktiviteti tregtar i bashkëshortit, prill 1994 - korrik 1997, në tregtimin e artikujve industrialë dhe ushqimorë*, pa përmendur të ardhura nga shitja e bimëve

medicinale. Në ankim, subjekti pretendon se të ardhurat nga grumbullimi dhe shitja e bimëve medicinale kanë qenë në vlerën 3.000.000 lekë dhe shprehet [...] *meqenëse në Tropojë nuk kishte banka dhe institucione shtetërore që funksiononin për arsye të mungesës së rendit, këtë periudhë bashkëshorti im ka punuar i palicencuar pasi nuk funksiononte shteti dhe, për këtë arsye, nuk kemi deklaruar të ardhura [...] kërkoj nga ana juaj të merret në konsideratë të favorshme për mua fakti i lartpërmendur [...]*. Në parashtrimet në Komision, ku bën të njëjtin deklaram, subjekti nuk referon ndonjë vlerë për këto të ardhura të pretenduara. Sa më sipër, pretendimet e subjektit për veprimtari të bashkëshortit për mbledhjen dhe tregtimin e bimëve medicinale dhe të ardhurat prej saj, mbeten të paprovuara dhe deklarative. Pavarësisht këtij fakti, për sa subjekti deklaron se bashkëshorti ka punuar i palicencuar, e në Komision e potencon se gjatë kësaj periudhë *nuk ka paguar taksa e tatime*, trupi gjykues vlerëson se, në asnjë option, të ardhurat e pretenduara nuk mund të kualifikoheshin dot si të ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

C.2 Pasuria e llojit automjet, i markës “Mercedes Benz”, tip “ML”, vit prodhimi 2008

30. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurisë së llojit “automjet”, të markës “Mercedes Benz”, tip “ML”, vit prodhimi 2008, në datën 10.02.2014, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit 84/2016.*
31. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për balancë negative prej (-) 449.969 lekësh, për periudhën 01.01.2014 - 10.02.2014, si të pambështetur e të paargumentuar dhe shprehet se u qëndron deklarimeve dhe parashtrimeve të saj në Komision. Sipas subjektit, marrëdhënia juridike mes bashkëshortit të saj dhe shtetasit E. K., shitës i automjetit objekt analize e njëherazi blerës i mjetit në pronësi të bashkëshortit të saj, në vetvete ishte një marrëdhënie juridiko-civile shkëmbimi, por u formalizua me dy kontrata shitjeje, për secilin automjet, për të mos pasur probleme në regjistrimin e pronësisë së automjetit të bashkëshortit. Subjekti shpjegon se këto veprime janë bërë të detyruar nga gjendja fizike e rënduar e djalit të saj, për të cilën u bë e nevojshme shitja e automjetit që kishin në pronësi dhe blerja e një automjeti me bagazh më të madh për nevoja të shoqërimit të tij në spitale. Sipas subjektit, për të mbuluar diferencën prej 500.000 lekësh mes çmimit të shitblerjes së këtij automjeti, përcaktuar në kontratë në shumën 950.000 lekë, me çmimin e shitblerjes së automjetit në pronësi të bashkëshortit të saj, përcaktuar në kontratë në shumën 450.000 lekë, është bërë garant një mik i përbashkët i palëve në kontratë, shtetasi I. Z., i cili është bërë ndërmjetës i këtij shkëmbimi dhe favorizimit për likuidim të plotë pas një periudhe 3-mujore, deklaratën noteriale të të cilit e ka depozituar në Komision.
32. Lidhur me pretendimet që i takojnë kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.
 - 32.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron: *autoveturë, tip “Benz ML”, vit prodhimi 2008, me targë {***}, blerë në datën 10.2.2014, me kontratë shitblerjeje nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, në pronësi të bashkëshortit A. M.; vlerë 950.000 lekë; pjesa takuese 50%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga shitja e autoveturës tip “Benz”, viti prodhimi 2000, me targë*

{***}, në vlerën 450.000 lekë, dhe pjesa tjetër nga kursimet e familjes. Në DIPP-2014, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar: (i) *shtim i pasurisë së luajtshme që vjen nga blerja e automjetit tip “Mercedes Benz”, me targë {***}, në pronësi të bashkëshortit A. M. Vlera: 900.000 lekë; (ii) pakësim i pasurisë së luajtshme që vjen nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz”, me targë {***} në pronësi të bashkëshortit A. M. Vlera: 450.000 lekë.*

32.2. Referuar kontratave të shitblerjes, me nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 10.02.2014, dhe nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 10.02.2014, të paraqitura prej subjektit bashkëlidhur deklarates *vetting*, konstatohet se automjeti i markës “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2000, tip “C220CDI”, është shitur në të njëjtën datë në të cilën është blerë nga personi i lidhur pasuria objekt shqyrtimi, automjeti i markës “Mercedes Benz”, tip “ML”, vit prodhimi 2008, dhe se blerësi i automjetit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2000, është i njëjti person i cili i ka shitur bashkëshortit të subjektit pasurinë objekt shqyrtimi, “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2008.

32.3. Në DIPP-2013, subjekti deklaron: [...] *gjendje cash, krijuar në vitin 2013, me burim nga të ardhurat nga paga e bashkëshortit. Gjendje në llogarinë pranë BKT. Vlera: 500.000 lekë. Pjesë takuese: 33% [...].* Të pyetur nga ILDKPKI-ja³², subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar se gjendja e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2013, ka qenë 0 (zero) lekë dhe paratë e kursyera në të gjitha vitet janë investuar për ndërtimin e shtëpisë dhe kompletimin e saj.

32.4. Trupi gjykues konstaton se në dy kontratat e referuara më sipër, citohet se palët njihen personalisht me njëri-tjetrin, se kanë rënë në marrëveshje mes tyre për shitjen e automjetit (me të dhënat dhe shumën përkatëse), *se janë likuiduar totalisht mes tyre për shumën dhe nuk kanë asnjë lloj detyrimi as tani, as në të ardhmen.* Referuar në përmbajtjen e kontratave, në kuptim të parashikimeve të Kodit Civil, nenit 659: “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”, si dhe nenit 660: “Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi”, konsideruar se vlera e pretenduar e papaguar në momentin e nënshkrimit të kontratës, përbën pothuaj $\frac{1}{2}$ e çmimit të shitjes në kontratë, palët në kontratë kanë pasur mundësi të përcaktojnë përmbajtjen e kontratave në përputhje dhe garantim të interesave të tyre. Përpos një kontrate “premtim shitje”, si alternativë e mundshme hipotetike që garantonte çdo të drejtë të palëve në situatën e pretenduar prej subjektit, duket jobindëse që, për shlyerjen e detyrimit prej 500.000 lekësh, si pjesë e pashlyer e çmimit të automjetit, palët të mos kenë përpiluar qoftë edhe një akt të thjeshtë mes tyre, por të kenë marrë garanci prej një të treti, pa e dokumentuar në asnjë lloj forme. Për më tepër, pretendimi i subjektit për formalizim me kontrata shitjeje për të mos pasur probleme në regjistrimin e pronësisë së automjetit të bashkëshortit, nuk vlerësohet bindës as prej trupit gjykues, për sa, siç vlerëson edhe Komisioni, nuk është kusht ligjor që përdoruesi i mjetit të jetë detyrimisht edhe pronar i tij.

32.5. Për sa më sipër, në lexim harmonik të nenit 690 të Kodit Civil: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”, me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron

³² Referuar dokumentit të datës 20.2.2015, “Sqarime në lidhje me deklarimin e pasurisë ndër vite, sipas kërkesës së inspektores”, dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresat nr. {***} prot., dhe nr. {***} prot., datë 11.2.2022.

veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar” – trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes për automjetin “Mercedes Benz”, tip “ML”, vit prodhimi 2008, bashkëshorti nuk ka paguar vlerën e plotë të blerjes sipas asaj që pasqyrohet në kontratën respektive të shitjes, mbeti deklarativ. Nga kontrolli i analizës financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen e kësaj pasurie në datën 10.2.2014. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

33. Trupi gjykues, pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit, i gjen të drejta përfundimet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në shumën (-) 5.448.462 për ndërtimin e pjesës takuese në pasurinë “shtëpi banimi”, tri kate dhe papafingo, në rrugën “{***}”, Tiranë, gjatë periudhës 1998–2012, dhe në shumën (-) 449.969 lekë për pasurinë automjet, të markës “Mercedes Benz”, tip “ML”, vit prodhimi 2008, e blerë më datë 10.02.2014.
34. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe brenda parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 567, datë 28.09.2022, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, gjendet i bazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit 567, datë 28.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Shefkie Mataj (Demiraj).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 25.02.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi